

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7478 E diel 25 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Kur ditë më parë media publikoi Klajmin se një grup prej 39 personash kishin trafikuar rreth 1.000 shtetas shqiptarë drejt perëndimit me shuma që ...
Vijon në faqen 21

Nga DRITAN HILA

Një reflektim për katastrofën demografike të vendit



Opinion i Ditës

Shumë shqiptarë e kanë pritur me një lloj shqetësimi emërimin nga Presidenti Donald Trump, të ambasadorit John Bolton, në postin kyç të këshilltarit ...
Vijon në faqen 22

Nga RUBEN AVXHIU

John Bolton dhe shqetësimi i shqiptarëve



INTERVISTA

Shembja e Teatrit, Suela Bako: Kult besimi dhe dashurie, aty pata 5 premiera

Aktorja: E kam të vështirë t'i jap lamtumirën, jam shumë e lidhur me traditën e historinë

Nga FATMIRA NIKOLLI

Në këtë Tiranë kryeqytet duan të ekzekutojnë ngrehinën e vetme Kombëtare të Teatrit, me pretekstin e një teatri të ri modern?! Jo, është e patolerueshme". Suela Bako vjen në "GSH" në një intervistë ku si pjesë e trupës ...
Në faqen 12

BASHKIM DEDJA: TE PLOTESOHEN VENDET BOSH. PD: FAJI I EDI RAMES

DOREZOHET KUSHTETUESJA, ALARMI: VENDI, PA GJYKATË

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese: Institucioni nuk funksionon, mbetën 5 anëtarë, duhen minimalisht 6. Oerd Bylykbashi: Gjithçka, falë vetingut të qeverisë



(Në foto) Gjykata Kushtetuese. Bashkim Dedja, kryetar i Gjykatës Kushtetuese

MINISTRI NE SHBA

Xhafaj takon nr. 2 të FBI: Identifikojmë ata që trafikuan 613 kg kokainë

Në faqen 2

PRECEDENTET

Grabitja në Fier, si funksiononte grupi "shëtites" në disa qytete

Në faqen 7

DYSHIMI MBI PROCESIN

KQZ, nën hetim nga "Prokurimet" për tenderin 60 milionë lekë

Në faqen 2

PERFITUESIT NE ATP

Dosjet e vitit '96, emrat e pronarëve që përfitojnë nga kompensimi

Në faqen 8-11

"MILOSAO"



Si e ka zbrërthyer imazhi kulturor rolin dhe figurën e Skënderbeut

Suplement

Mediat angleze, detaje për 7 grupet kriminale që çuan 750 persona

Trafiku, 20 mijë paund për të shkuar në Britani

"Koka" e linjës, shqiptar me nënshtetësi irlandeze. Roli i EUROPOL-it

Pak ditë pas zbulimit dhe goditjes së shtatë grupeve kriminale që trafikonin emigrantë të paligjshëm nga Shqipëria drejt Anglisë, Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mediat britanike i kanë kushtuar vëmendje operacionit të



zhvilluar nga autoritetet shqiptare në bashkëpunim me EUROPOL. Në një artikull të publikuar ditën e djeshme nga e përditshmja "Daily Mail", pasqyrohet operacioni ku u arrestuan 39 persona dhe u shpallën në kërkim 12 të tjerë ...
Në faqen 6



Bylykbashi: Gjykata pushoi së ekzistuari de facto, falë vetingut të Ramës

'Kushtetuesja', Dedja: Procedurat për vakancat të përshpejtohen

"Gjykata, jo funksionale në disa aspekte"

Valentina Madani

Pas vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të shkarkuar gjyqtarin Fatos Lulo, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka hyrë zyrtarisht në kolaps. Tashmë, gjykata më e lartë e vendit ka mbetur me 5 anëtarë dhe ajo nuk mund të marrë në shqyrtim asnjë çështje, pasi për të qajtur të vlefshme një mbledhje, duhen minimalisht 6 gjyqtarë. Nga Gjykata Kushtetuese dha dorëheqjen para vetingut, anëtari Besnik Imeraj, ndërkohë më herët është larguar Vladimir Kristo, të cilit i kishte mbaruar mandati prej disa vitesh. Ndërsa më parë dha dorëheqjen edhe gjyqtari Sokol Berberi. Pezullimi i Fatos Lulos deri sa të përfundojë procesi i apelimit e ka futur zyrtarisht Gjykatën Kushtetuese në ngërc institucional. Veç 3 vakancave të krijuara nga dorëheqja e Vladimir Kristos, Sokol Berberit dhe Besnik Imerajt, pezullimi i Lulos nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit e lë këtë gjykatë vetëm me 5 nga 9 anëtarë, çka e bën të pamundur gjykimin dhe vendim-marrjen e saj për të gjitha çështjet në shqyrtim. Neni 32 i ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese parashikon se seancat gjyqësore mund të zhvillohen vetëm me pjesëmarrjen e të paktën 2/3-ve të anëtarëve të saj. Pra, në sallë duhet të jenë 6 nga 9 anëtarët.

KËRKESA
Kreu i Gjykatës Kushtetuese, Bashkim Dedja nuk e konsideron si rënien e këtij institucioni, por ai kërkon procedura të përshpejtuara për plotësimin e vendeve vakante. I kontaktuar dje nga "TCH", Dedja pyetjes nëse ka rënë apo jo Gjykata Kushtetuese iu përgjigj: "Jo, unë nuk mund të them që Gjykata Kushtetuese ka rënë, por mund të them që Gjykata Kushtetuese nuk funksionon më në disa aspekte të saj, që janë vendimet e seancës plenare dhe vendimet e mbledhjes së gjyqtarëve", tha Ded-



Deputeti i PD, Oerd Bylykbashi

DEKLARATA



DEDJA

"S'mund të them që gjykata ka rënë, por nuk funksionon më në disa aspekte të saj, që janë vendimet e seancës plenare dhe vendimet e mbledhjes së gjyqtarëve", tha z.Dedja.



BYLYKBASHI

"Çdo shtetas që kërkon të gjëjë të drejtën e tij kushtetuese nuk mundet më. Madje është e kotë të trokasë në dyert e Kushtetueses. Aty nuk përgjigjet më askush!", tha z.Bylykbashi.



KANDIDATËT

Ligji parashikon se kandidatët për anëtarë të Kushtetueses duhet të kalojnë vetingun përpara se të emërohen. Edhe vetë politika në këtë rast është e ndarë. Gjykata duhet të kishte nëntë anëtarë.



ja. Por, mosfunksionim në seancë plenare do të thotë se gjyqtarët kushtetues nuk mund të dalin më në seancë për të zhvilluar këto procese sipas këtij kalendari të paralajmëruar. Dedja përsëriti të njëjtin apel për zëvendësimin e vendeve vakante. "Tashmë Gjykata Kushtetuese nuk formon dot kuorumin me gjashtë anëtarë, e vetmja gjë që mund të them është të përshpejtohen procedurat për zëvendësimin e vendeve vakante", tha z.Dedja.

OPOZITA

Një ditë pasi Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shkarkoi nga detyra gjyqtarin e Kushtetueses, Fatos Lulo për shkak të vetingut, reagoi edhe PD-ja. Deputeti i PD, Oerd Bylykbashi, akuzon kryeministrin Edi Rama duke thënë se ky është një veting i Ramës, ndërsa shton se gjykatat janë nën presionin e tij. Deputeti demokrat shprehet se iu dha goditja e fundit gjykatave, ndërsa thekson se Gjykata Kushtetuese pushoi së ekzistuari de facto, falë vetingut të Ramës. "Goditja e fundit u bë dje. Gjykata Kushtetuese dje (pardje) pushoi de facto se ekzistuari falë vetingut të Rames. Nuk dihet për sa kohë. Ka vetëm 4 anëtarë me mandat të rregullt nga 9 që është totali. Ç'çdo shtetas që kërkon të gjëjë të drejtën e tij kushtetuese nuk mundet më. Madje, është e kotë të trokasë në dyert e Gjykatës Kushtetuese. Aty nuk përgjigjet më askush!", shprehet z.Bylykbashi. Duke i kujtuar kryeministrin se qeveris me VKM, duke iu referuar vendimit për pezullimin e regjistrimit të titujve të pronësisë, ai shtron pyetjen: "Po ku ta kërkojë të drejtën përballë qeverisë? Gjykatat kanë rënë si pushtet që kon-

ZGJIDHJA

Situata e krijuar nuk ka gjasë të zgjidhet në një kohë të shpejtë. Edhe pse presidenti dhe Kuvendi e kanë nisur procesin e zëvendësimit për 3 nga vakancat, madje duke mbyllur dhe procesin e depozitimit të kandidaturave, hallka që mban peng përzgjedhjen e tyre është Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

ASTRIT PATOZI

"Nëse reforma në drejtësi e ka një kundërshtar serioz në Shqipëri, ai është kryevetinguesi, kryereformatori, kryeparlamentari, kryeprokurori, kryegjykatësi, kryeredaktori i përgjithshëm i mediave dhe kryearkitekti, jo vetëm i fitoreve tona, por edhe i godinave, rrugëve dhe shesheve të vendit", tha z.Patozi.



"Marrëdhëniet Shqipëri-Greqi, hapa prapa"

Pakti detar, Dule fajëson Ramën: Na mbajti peng 5 vjet

Kreu i PDBNJ-së akuzon kryeministrin Rama se ka mbajtur peng marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë për 5 vite. Dule, e cilëson të drejtë marrëveshjen e Detit me Greqinë të 2009-ës, por shpreson që negociatat të konkludojnë në një rezultat të drejtë dhe efektiv. Për kreun e PBDNJ, ndarja e detit duhet të bëhet sipas Konventës respektive të Kombeve të Bashkuara, e cila parashikon çdo aspekt të procesit dhe është ratifikuar nga të dyja vendet. "Greqia dhe Shqipëria janë të vonuara në arritjen e marrëveshjes", - shprehet Dule. Kreu i PBDNJ-së ishte i pranishëm në një aktivitet të organizuar me rastin e festës së Greqisë në Korçë. Pavarësisht vendimit të Kushtetueses për marrëveshjen e 2009-ës, Dule tha se e drejta ndërkombëtare prevalon mbi të drejtën e vendit, përfshirë edhe Kushtetutën. "Në këto 5 vitet e fundit janë bërë hapa prapa në marrëdhënie me fqinjin tonë, të cilat kanë kosto jo të vogël. Marrëdhëniet midis dy vendeve nuk mund të mbahen peng për një kohë të gjatë, sepse ato janë solide dhe të shtrira në histori dhe në të tashmen. Rama nuk mund të mbajë peng vendin në marrëdhëniet me Greqinë", tha z.Dule. Sa i takon marrëveshjes për detin, Dule vlerëson si të drejtë marrëveshjen e vitit 2009 dhe shpreson që negociatat të konkludojnë në një rezultat të drejtë dhe efektiv. "E drejta ndërkombëtare prevalon mbi të drejtën e vendit, përfshirë dhe Kushtetutën. Greqia dhe Shqipëria janë të vonuara në arritjen e marrëveshjes", - shprehet Dule.

ERVIN SALIANJI

Opozita denoncon shkeljet ligjore të qeverisë

Deputeti i PD-së, Ervin Saliq, denoncoi dje skemën se si deputeti i PS-së, Alket Hyseni arriti të grabisë 11 mijë metra katrorë tokë në Dhërmi. Saliq kërkon të merret në hetim parlamentari socialist Alekt Hyseni për akuzën "e rëndë të grabitjes së 11 mijë metra katrorë tokë në Dhërmi". "Vetë Alekt Hyseni, i besuari i Edi Ramës, për të verifikuar tjetërsimin e pronave në bregun e jugut nga viti 2014 deri në vitin 2016, nuk ka dhënë asnjë shpjegim sesi u bë pronar i një prone, transakcioni për të cilën ishte ndaluar me vendim nga Gjykata e Vlorës. Alket Hyseni duhet t'i përgjigjet pyetjes sesi ia doli të bëjë kaq shumë pasuri në një kohë kaq të shkurtër", tha z.Saliq.

trollon teprimet e qeverisë. Parlamenti është kukull. Ka vetëm veting. Vetingu është bërë si fronti demokratik dhe gjyqet e vetingut duken si gjyqet publike komuniste të 1945 të kinema '17 Nëntori'. Se mos guxon njeri dhe e kundërshton ideologjinë e re, vetingun, se shpallet armik! Por gjykatat e vetingut nuk zgjidhin padrejtësitë me pronat, tatimet, doganat apo policinë, as janë Gjykatë Kushtetuese. Dhe mos harroni: asnjë nga gjyqtarët e vetingut nuk e ka kaluar vetingun vetë!"

PERMBYTJET AKUZAT

Kreu i PD-së me telefon në dorë, filmon banorët e revoltuar: Rama na ka mbytur

Basha denoncon përmbytjen: Të shpallet emergjencia

"Shkodranët nën ujë, të përbuzur nga kryeministri"

Valentina Madani

Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, denoncoi sërish dje situatën e rëndë nga përmbytjet në qarkun e Shkodrës. Basha ishte sërish dje në Shkodër, pranë banorëve të përmbytur, ku i veshur me xhup e kapuç, me telefon në dorë ka regjistruar vetë banorët, që të revoltuar kanë shprehur zhgënjimin për qeverinë dhe kryeministrin Edi Rama. Madje, ata kanë akuzuar kryeministrin se i ka mbytur. "Realiteti, përtej propagandës. E vërteta, përtej mashtrimit. Shkodranët nën ujë, të braktisur dhe të përbuzur nga Edi Rama", shkruan Basha teksa publikon videon. Qytetarët shkodranë ndihen tërësisht të braktisur nga qeveria dhe kryeministri Edi Rama. Banorët e përmbytur janë shprehur se nuk kanë marrë asnjë ndihmë nga qeveria. Ata flasin mes shiut, duke kërkuar shpalljen e emergjencës. Ata i kanë bërë thirrje Ramës që të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme, pasi situata është kritike. "Të shpallin emergjencën. Këtu nuk dihet kush është kryeministri. E dimë kush është kryeministri, ai që është, ai që na ka mbytur brenda. Një njeri që nuk vjen të shikojë si është gjendja e popullit të vet në këtë vend, për mua nuk vlen, nuk është askush. Kam lindur socialist, jam socialist, por sot jam totalisht i zhgënjyer", shprehet njëri nga banorët e përmbytur. Nisur nga kjo situatë e vështirë, kreu i PD-së, Lulzim Basha përsëriti edhe njëherë kërkesën për shpalljen e gjendjes së emergjencës në Shkodër. Në një postim në rrjetet sociale, ku kreu i Partisë Demokratike shfaqet krahas banorëve në këtë qark, ai bën përgjegjës për përmbytjet KESH. Ai publikoi një sërë pamjesh, ku banorët ankojnë se nuk kanë vëmendjen e qeverisë dhe kërkojnë shpalljen e emergjencës, ndërkohë që banesa e rrugë nën ujë dhe njerëz që mundohen të kalojnë me varkë shfaqen në njësitë si Dajç, Ana e



Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha në Shkodër

DENONCIMI

Basha ishte sërish dje në Shkodër, pranë banorëve të përmbytur, ku i veshur me xhup me kapuç, me telefon në dorë ka regjistruar vetë banorët, që të revoltuar kanë shprehur zhgënjimin për qeverinë dhe kryeministrin Edi Rama.

LSI, Braimllari: Emërimet në administratë, në kundërshtim me ligjin

LSI denoncoi dje qeverinë për emërimet të paligjshme në administratë. Sekretari i Përgjithshëm i kësaj partie, Endrit Braimllari shprehet se administrata publike sot është tërësisht në kundërshtim me ligjin. Deputeti i LSI u shpreh se Rama ka emëruar Afrim Qendron si kreun e Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Frida Krifcën si drejtore të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, në kundërshtim me ligjin për Administratën dhe jashtë kritereve të Bashkimit Europian. "Sot administrata publike është tërësisht në kundërshtim me ligjin, duke



Sekretari i Përgjithshëm i LSI-së, Endrit Braimllari

dalë edhe kundra BE, që vetë Edi Rama e propagandonte me të mëdha që do të sillte ndryshim rrënjësor në administratën publike. Tërsia i është kalbur dhe i ka ngelur në dorë nga paaftësia e tij dhe njerëzve që e rrethojnë", theksoi ai. Sipas tij, drejtori i Autoritetit Rrugor, Afrim Qendro dhe drejtoresha e

AZHBR-së, Frida Krifca janë emëruar në kundërshtim me ligjin e Shërbimit Civil. "LSI ka bërë gati materialet dhe do t'u drejtohet institucioneve të Bashkimit Europian, por edhe prokurorisë duke shpresuar në një hetim të pavarur të këtij rasti", deklaroi deputeti Braimllari.

le, thekson Basha. Dy ditë më parë kryetari i opozitës ndodhej në këto zona, ku në takimin me komisionin e

emergjencave të Bashkisë Shkodër, tha se mosshpallja e emergjencës do të ketë përgjegjësi penale ligjore.

Permbartues gjyqësorë Gentil Bushati nxjerr për shitje në ankad pasurinë :

"Pentore+Truall+Nderitese me sip totalite 620m2, nga e cila 200 m2eshite truall dhe 90 m2 eshte nderitese , me Numer pasurite 430/17, e ndodhur ne Zonen Kadastrele 1100, e regjistruar ne regjistrin hipotekore volumi 6, faqe 227, me adrese ne Fshatin Barbuliush Shkoder
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankad për pasurinë e sipërpërkshuar , eshte në Vleren 1,568,000 (njemilone e pesëqind e gjashtëdhjetetele mije) Lekë .
Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me date **26.03.2018 ora 16.16** ne Zyren e permbartuesit gjyqësorë Gentil Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykatës se rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhen perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051.



NARD NDOKA

Përmes një fotomontazhi, Ndoka tregon veprimet e Edi Ramës kur ishte në opozitë (shfaqet hipur në një varkë tek viziton zonat e përmbytura) dhe se si vepron ai tani (shfaqet i ulur dhe i relaksuar me këmbë sipër tavolinës).

"Rrjedhjet" e këshilltarëve të LSI, ikin edhe dy në Korçë

Dy këshilltarë të LSI në Këshillin Bashkiak të Korçës i janë bashkuar Partisë Socialiste. Marilena Dervishi dhe Shkëlqim Larti përmes një deklaratë publike bënë të ditur largimin. "Jam sot këtu për të ndarë me ju një vendim, të cilin e kam menduar dhe ndarë shpesh me miqtë dhe bashkëpunëtorët e Lëvizjes Socialiste për Integritim. Unë jam një nga njerëzit e parë që i jam bashkuar kësaj force politike në Korçë, qysh në krijimin e saj, me përgjegjësinë e një ish-ushtaraku për të kontribuar për komunitetin dhe vendit tim. Sot e gjej veten përballë dy rrugëve, të vazhdoj të jem përkrah këtij transformimi apo t'u bindem porosive politike të LSI, që këtu në Bashkinë e Korçës, më shumë se kudo tjetër nuk gjejnë dot vend. Unë sot vendosa të mos e braktis atë që kam bërë deri më sot dhe t'i bashkohem grupit të Partisë Socialiste, duke lënë pas rrugën e porosive të bllokimit që vijnë nga Tirana", deklaroi Larti. Pas largimit të dy këshilltarëve nga LSI, Këshilli Bashkiak i Korçës shkon me 23 mandate PS, 6 LSI dhe 12 PD.



Çollaku: PD e ka përcaktuar timonierin, debat si të forcohem

Kreshnik Çollaku, anëtar i kryesisë së PD, deklaroi se debati brenda PD-së duhet të zhvillohet dhe të jetë produktiv. Sipas Çollakut, debati në PD duhet të orientohet se si kjo forcë politike të korrigjohet, forcohet dhe po ashtu edhe për perfeksionimin e rregullave të lojës. Debati që nuk duhet të humbim... "Debati i madh që vlen të bëhet sot është mbi busullën se si ky timonier do ta drejtojë partinë për 4 vitet në vijim. Rasti për këtë debat të madh e jetik është Kuvendi Kombëtar, është një mundësi, të cilën nuk duhet e nuk mundet ta shpërdorojmë, është një debat që nëse e zhvillojmë me pjekuri ndershmëri dhe hapur, do të na nxjerrë të bashkuar e më të fortë", shprehet z.Çollaku.



ITALI - Policia italiane arrestoi dy ditë më parë shtatë shqiptarë, të cilët akuzohen për një seri grabitjesh. Në sajë të operacionit të koduar 'Off line' u shkatërrua banda shqiptare, e cila vepronte midis zonës së Toskanës dhe Umbrias. Ndërkohë, dyshohet se përgjatë pesë muajve të fundit pjesëtarët e kësaj bande kanë kryer 6 grabitje në ditë. "La Nazione" shkruan se shqiptarët pasi hynin në bane



Arrestohet edhe shpërndarësi i drogës, Eral Sulçaj

Shkatërrohet banda e grabitësve, shtatë shqiptarë në pranga

sat e italianëve, merrnin prej aty sende të shtrenjta, unaza dhe florinj dhe me pas i shinin, ndërsa paratë i dërgonin në Shqipëri. Banda e kishte shtrirë aktivitetin kriminal

në Siena, Arezza, Firenze e Perugia. Policia italiane vijon ende hetimet për dokumentimin e plotë të këtij rasti. Ndërsa, dje policia italiane në Modica ka vënë në pranga 32-

vjeçarin Erald Sulçaj, pasi në banesë iu gjet 5 kg marrijuanë. Sulçaj mbahej nën vëzhgim, pasi dyshohej se ishte përfshirë në shpërndarjen e lëndëve narkotike.

"Udhëheqësi i një prej 7 grupeve, shqiptar me nënshtetësi irlandeze"

5 hapat për të shkuar në Britani, rruga që ndiqnin trafikantët shqiptarë

"Daily Mail": Kriminelët trafikuan 750 persona kundrejt pagesës deri në 20.000 paund

BRITANI

Pak ditë pas zbulimit dhe goditjes së shtatë grupeve kriminale që trafikonin emigrantë të paligjshëm nga Shqipëria drejt Anglisë, Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, mediat britanike i kanë kushtuar vëmendje operacionit të zhvilluar nga autoritetet shqiptare në bashkëpunim me EUROPOL. Në një artikull të publikuar ditën e djeshme nga e përditshmja "Daily Mail", pasqyrohet operacioni ku u arrestuan 39 persona dhe u shpallën në kërkim 12 të tjerë. Në të zbulohet edhe rruga që ndiqnin trafikantët për të dërguar drejt Britanisë emigrantët e paligjshëm kundrejt pagesës prej 10.000 paund. Sipas "Daily Mail", operacioni ndërkombëtar zbuloi më shumë se 50 njerëz që merreshin me trafikimin duke bërë miliona. Destinacionet përfundimtare ishin Mbretëria e Bashkuar, SHBA dhe Kanada. Sipas kësaj medie, 750 shqiptarë përfunduan në Britani, të trafikuar nga kriminelët që merrnin deri në 20 mijë paund. Nga ana tjetër, britanikja "The Sun" thotë se udhëheqësi i një prej grupeve më të fuqishme të trafikut të klandestinëve, duke iu referuar grupit shqiptar që u shkatërrua nga policia, është me nënshtetësi irlandeze. Në shkrim theksohet se personi, identiteti i të cilit nuk bëhet i ditur, është me origjinë shqiptare, por ka jetuar më parë në jug të Dublinit. "Ky individ është një prej personave kryesorë të grupit dhe dyshohet se është shumë i përfshirë në trafikim. Ai dyshohet se është pjesë e mafies shqiptare dhe është përfshirë në shumë aspekte të kimit të organizuar", thotë një burim për "The Sun". Po autoritetet kanë edhe një tjetër shqetësim. Shqiptarët tani përbëjnë grupin e tretë më të madh të huaj të burgosur në Angli dhe Uells, pas kriminelëve irlandezë dhe polakë. 'NCA' thotë se bandat shqiptare kanë 'kontroll të konsiderueshëm' të tregut të drogës në Mbretërinë e Bashkuar. Kathryn Holloway, komisar i policisë dhe kimit të Bedfordshire, tha se: "Brutaliteti i tyre i lartë, janë më të pamëshirshmit që Mbretëria e Bashkuar e ka parë". Gjithnjë sipas asaj që shkruan media britanike, shqiptarët janë tashmë grupi i tretë më i madh i të huajve të burgosur në Angli dhe Uells, pas kriminelëve irlandezë dhe



polakë. Sipas Ministrisë së Drejtësisë britanike, vitin e shkruar numëroheshin 726 kriminelë nga Ballkani në burgjet britanike, gati trefishi i vitit 2013, kur numri ishte 267. Në operacionin e zhvilluar autoritetet shqiptare e përsh-

kruan një "mega operacion", morën pjesë zyrtarë nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Agjencia Kufitare e Kanadasë, Europol, Interpol, policia në Kosovë, Spanjë e Itali. "DailyMail" sjell gjithashtu në vëmendje se vitin e shkruar, Shqipëria ishte vendi i dytë me



numrin më të lartë të fëmijëve të pashoqëruar që kërkonin azil në Britani, më shumë aplikantë sesa Siria e shkatërruar nga lufta. Dy ditë më parë, e njëjta media shkruante për mbipopullimin e burjeve britanike për shkak të rritjes së bandave kriminale shqiptare.

Ndërsa po gjatë kësaj të shtune, një tjetër media britanike, "The Sun", pasqyrohet në një operacion të policisë kundër trafikantëve dhe zbulonte se një prej kokave të kësaj bande ishte me origjinë shqiptare, me nënshtetësi irlandeze.

SHKURT

Arrestohet 45-vjeçari, policia: I rrezikshëm!

BERAT - Një 45-vjeçar, i cili cilësohet si person me rrezikshmëri të lartë kriminale është arrestuar dje nga policia e Beratit. Bëhet fjalë për Edison Çoban, i cili ishte shpallur në kërkim. "Në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative u bë e kapja e shtetasit në kërkim, Edison Çobo, banues në lagjen 'Çlirim', Berat. Shtetasi i lartpërmendur është shpallur në kërkim pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pier me vendim nr.4137 dt.25.09.2017 ka caktuar masën e sigurisë 'Arrest me burg', për veprën penale, 'Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike, kryer në bashkëpunim', parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Gjithashtu, ndaj këtij shtetasi ka nisur hetimi pasuror, ku për këtë materialet hetimore i kanë kaluar Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë", thuhet në njoftimin e policisë.

Në kërkim për drogë, pranga të riut nga Fushë-Krujë

SHKODËR - Policia e Shkodrës ka prangosur një 30-vjeçar, i cili ishte shpallur në kërkim për prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike. "Në vijim të operacionit të koduar 'Ndaleza e Fundit' u bë kapja dhe arrestimi i shtetasit: Edmond Xaka, banues në Fushë Krujë. Ky shtetas ishte shpallur në kërkim, pasi Prokuroria Pranë Gjykatës Shkallës Parë Shkodër ka nxjerrë urdhër ndalimi për këtë shtetas si i dyshuar për veprën penale 'Prodhim dhe shitje e lendeve narkotike' e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprim të mëtejshme", thuhet në njoftimin e policisë.

Policia: Ngjarja mori shkak për motive të dobëta

Sherri me armë në një lokal në Kamëz, përfundojnë në pranga 7 persona

TIRANË - Policia e Tiranës ka arrestuar 7 persona në lidhje me sherrin që ndodhi dy ditë më parë në një lokal në Laknas të Kamëzës, ku si pasojë e një konflikti mes disa të rinjve pati edhe të shtëna me armë zjarri. Sipas bluve, ngjarja ka ndodhur për motive të dobëta dhe fatmirësisht nuk pati persona të lënduar. Mësohet se 4 persona u arrestuan për akuzën e vrasjes së mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim. Bëhet fjalë për shtetasit: Ardjan Shima, 37

PERSONAT E ARRESTUAR		
1.	Ardjan Shima	37 vjeç
2.	Klejdian Deliu	35 vjeç
3.	Elfordj Deliu	23 vjeç
4.	Shkëlzen Khanari	33 vjeç
5.	Gentjan Neli	36 vjeç
6.	Renaldo Dragjoshi	29 vjeç
7.	Andi Karaj (Metalu)	35 vjeç

vjeç, banues në Kamëz, i dënua më parë për vjedhje; Klejdian Deliu, 35 vjeç, banues në Kodër-Kamëz; Elfordj Deliu, 23 vjeç, banues në Laknas dhe Shkëlzen Khanari, 33 vjeç,

banues Kodër-Kamëz. Ndërsa 3 persona të tjerë u arrestuan për akuzën e moskallëzimit të kimit. Ata janë Gentjan Neli, 36 vjeç, banues në Kamëz; Renaldo Dragjoshi, 29 vjeç



Pistoleta e sekuestruar nga policia

dhe Andi Karaj (Metalu), 35 vjeç, të banues në Laknas. "Arrestimi i tyre u bë pasi të premtën, në një lokal në Laknas, Ardjan Shima, Klejdian Deliu, Gentjan Neli, Shkëlzen Khanari dyshohen se gjatë një konflikti për motive të dobëta kanë goditur me grushte A. Karaj. Pas kësaj, Ardjan Shima dyshohet se ka qëlluar dy herë me armë zjarri", thuhet në njoftimin e pol-

icisë. Ndërsa, Renaldo Dragjoshi, Gentjan Neli, të cilët pasi ishin prezentë në këtë konflikt, deri në momentin e identifikimit dhe shoqërimit nuk kanë kallëzuar në lidhje me ngjarjen e ndodhur. Ardjan Shimës iu gjet dhe sekuestrua edhe arma e përdorur në këtë ngjarje, një pistoletë së bashku me 11 copë fisheke, të cilën e dispononte pa leje të organeve kompetente.

T arrestuari Arben Muça "kyç" gojën. Në kërkim vëllai i tij dhe një tjetër

FIER

Një ditë pas grabitjes së banesës së 68-vjeçarit Minella Muçi në Fier, ku mbeti i vrarë 20-vjeçari Xhuljan Sollaku nga Elbasani si dhe u plagos 35-vjeçari Arben Muça me origjinë nga Puka, burime nga policia bënë me dije se bëhet fjalë për një grup të sofistikuar kriminal. "Shëtites", profesionistë dhe të dhunshëm. Ky është përshkrimi, që hetuesit kanë për grupin e grabitësve, i cili në orët e para të mëngjesit të së premtes shkëmbu zjarr për afro 15 minuta me policinë në lagjen "29 Nëntori" të qytetit të Fierit. Sipas hetuesve të çështjes, ka të dhëna se ky është grup që ka kryer një sërë grabitjesh me armë kohët e fundit në qytete të ndryshme të vendit. Dhe në çdo grabitje policia nuk ka gjetur asnjë gjurmë, që mund të çonte në identifikimin e tyre. Ndërkaq, mësohet se familja Muçi ka një djalë që jeton prej vitesh në Meksikë. Pikërisht ky fakt dyshohet se ka shtyrë grabitësit të tentonin të hynin në banesë, pasi kanë pasur informacione se dy pensionistët mund të kishin para kesh në shtëpi. Hetuesit besojnë se grabitësit e kanë vëzhguar prej kohësh familjen Muçi. I arrestuari i vetëm i ngjarjes së rëndë, Arben Muça (u plagos në këmbë) nuk ka pranuar të bashkëpunojë me policinë. 35-vjeçari është marrë në pyetje në spitalin e Fierit, por nuk ka dhënë asnjë detaj të vlefshëm që mund të çojë në arrestimin e dy personave të tjerë, që morën pjesë në grabitje. Ndërsa, vijon të jetë në kërkim vëllai i tij, Ardi Muça dhe një person tjetër, i cili dyshohet se është nga Fieri dhe njohës i mirë i lagjes "29 Nëntori", ku ndodhi ngjarja.

HETIMET

Grabitësit (të maskuar dhe të armatosur me automatikë e pistoletë), të cilët tentuan të vidhnin banesën e Minella Muçit, dyshohet të kenë bashkëpunuar prej kohësh me njeri-tjetrin. Burime për "Gazeta Shqiptare" dje bënë me dije se ka dyshime që të paktën njëri prej tyre është nga Fieri, i cili ka orientuar shokët e tij se në banesën e Minella Muçit mund të këtë pasur një sasi të konsiderueshme parash. Ndërkohë, nisur nga rindërtimi i ngjarjes dhe hetimet paraprake është konkluduar se çifti i të moshuar nuk kanë pasur sende me vlerë apo shumta të madhe parash në banesë, pavarësisht se grabitësit dyshohet të kenë pasur informacion se djali i Minellës, i cili jeton në Meksikë mund të kishte kryer ndonjë transfertë valute. Nga verifikimi i të kaluarës së dy prej grabitësve, Xhuliano Sollaku, që mbeti i vrarë pas shokëmbimit të zjarrit me policinë dhe Arben Muça, i cili u plagos, është konstatuar se ata kanë pasur prej vitesh aktivitet të

Tentativa e grabitjes në Fier, ja si funksiononte grupi kriminal që u përplas me policinë

Policia: Autorët, "shëtites" profesionistë e të dhunshëm, dyshohen për një seri bastisjesh në disa qytete të vendit



I plagosuri Arben Muça



20-vjeçari i vrarë, Xhuljan Sollaku



Pallati ku banon familja Muçi

dyshimë. Gjithashtu, mësohet se është konkluduar paraprakisht se ata janë anëtarë të një grupi që dyshohet se ka kryer vjedhje me armë e vepra të tjera penale edhe në qytete të tjera të Sh-

qipërisë. Hetuesit kanë ngritur dyshimet se grabitësit bashkëpunonin gjithmonë me banorë të qyteteve ku kryenin vjedhjet. Policia thotë se kemi të bëjmë me një grup profesionistësh, që nuk lë pas

DJALI I FAMILJES MUÇI

Familja Muçi ka një djalë që jeton prej vitesh në Meksikë. Pikërisht ky fakt dyshohet se ka shtyrë grabitësit të tentonin të hynin në banesë, pasi kanë pasur informacione se dy pensionistët mund të kishin para kesh në shtëpi. Hetuesit besojnë se grabitësit e kanë vëzhguar prej kohësh familjen Muçi. I arrestuari i vetëm i ngjarjes së rëndë, Arben Muça (u plagos në këmbë) nuk ka pranuar të bashkëpunojë me policinë.

as shenja gishtërinjsh dhe as gjurmë që mund të çojnë në identifikimin e tyre. Akoma dhe më shumë hetuesit i frikësohen faktit se grabitësit janë të pamëshirshëm dhe në çdo moment mund të hapin zjarr kundrejt atyre që iu prishin planin. Me vete kishin përveç armëve, dorezave dhe maskave, edhe një çantë me vegla që do të shërbente për

të hapur derën. Sipas policisë, ishte mbërritja në kohë e efektive që pengoi planin e grabitësve. Nëse policia do të vonohej edhe për disa minuta, grabitësit do ta kishin hapur derën me veglat që dispononin. Në rastin e grabitjes së të moshuarit Minella Muça, ishte mbërritja në kohë e efektiveve, ajo që pengoi planin e grabitësve.



I gjendet arsenal armësh në banesë, kapet Ervin Çizmja

DURRËS - Policia e Shijakut në bashkëpunim me Forcat e Posaçme "Shqiponja" të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës dje arrestuan në flagrancë 31-vjeçarin Ervin Çizmja 31 vjeç, banues në Shijak. Pas informacioneve të marra në rrugë operative, blutë kanë ushtruar kontroll në banesën e shtetasit në fjalë, ku u gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e pro-vave materiale: një armë zjarri pistoletë "TT" model 54, kalibër 7.62 mm me krehër; një armë gjahu teke; 261 fishekë; një silenciator arme zjarri me gjatësi të përgjithshme 23 cm dhe një gjerdan me 28 fishekë arme gjahu. Materialet i kaluan prokurorisë së Durrësit për veprime të mëtejshme për veprat penale "Mbjajtja pa leje e armëve luftarakë" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive".

E reja kundërshtoi e fyeu blutë, i sekuestrohen 2 thika

Shisnin kokainë në lokalin e natës, policia e FNSH arreston 2 pronarët dhe një vajzë

FIER - Tre persona, mes të cilëve dhe një femër janë prangosur nga policia e Fierit, pasi janë kapur duke shpërndarë kokainë në një lokal nate, ku po organizohej një festë "party". Mësohet se në kuadër të operacionit të koduar "Mesnata", u arrestuan të rinjtë: Shkëlzen Gjata, 24 vjeç, banues në Drizë, Fier; Mariglen (Renato) Mellara, 35 vjeç, banues në Fier (pronarë të lokalit) si dhe 27-vjeçarja Pranvera Isufaj po nga Fieri. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së këtij qarku dje bënë me dije se

arrestimi i tyre u bë i mundur mbi bazën e informacioneve të siguruar më parë në rrugë operative se në lokalin "New York" në lagjen "Apolonia", Fier gjatë një feste "party" që do të zhvillohej aty, do të shitej lëndë narkotike. Mbi bazën e këtij informacioni, është organizuar puna dhe në bashkëpunim me FNSH Fier, gjatë mesnatës, është shkuar në lokalin "New York" dhe është u ushtruar kontroll personave dhe ambienteve të këtij lokalit, që ishte në administrim nga shtetasit Shkëlzen Gjata dhe Mariglen Mellara. Nga kontrolli i ushtruar në

një dhomë me mbishkrimin "Private" u gjendën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 36 copë paketime (porcione) me lëndë narkotike e dyshuar kokainë, një peshore elektronike, një palë gërrshërë, një fletore shënimesh etj. Gjatë kohës së kontrollit fizik të personave që ishin në këtë lokal dhe më konkretisht të shtetasve Pranvera Isufaj, në çantën e saj të krahut i janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale 2 (dy) thika me te të përkulshëm të dyshuara si armë të ftohta. Mësohet se Pranvera Isufaj ka



Materialet e sekuestruara nga policia e Fierit

kundërshtuar hapur veprimet e policisë, duke përdorur dhe forcën me veprime aktive e për pasojë ka penguar në kryerjen e detyrës punonjësit e policisë si dhe i ka ofenduar ata. Materialet procedurale i kaluan prokurorisë së Fierit në ngarkim të shtetasve Shkëlzen Gjata dhe Mariglen Mellara për veprën penale

"Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike", "Përshtatja e lokalit për përdorim droge" dhe "Nxitja për përdorimim e drogës" dhe ndaj shtetasve Pranvera Isufaj për veprat penale "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta" dhe "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik".

Ornela Manjani

ATP: Dosjet e vitit 1996, pronarët që kompensohen

Ish-pronarët, aplikimet e ezauruara

Agjencia e Trajtit të Pronave publikon listën me 4900 pronarë, të cilëve u është njohur e drejta për kompensim. Dosjet i përkasin vitit 1996. Lista me vlerësimin përfundimtar për subjekte është botuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Trajtit të Pronave. Lista përmban të dhëna lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuar, sipërfaqja e njohur për kompensim, mangësitë në dokumentacion apo vlerësimin përkatës jepen të detajuara në regjistrin që shqëron këtë njoftim. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfuturit si dhe vlerësimin financiar për çdo dosje.

KOMPENSIMI FINANCIAR

Bazuar në skemën që po ndjek qeveria në zbatim të ligjit të ri për pronat, prioritet do të ketë prona truall, përkundër tokave bujqësore, që do të jepen për kompensim fizik. Pas shqyrtimit të

kërkesave, kompensimi financiar bëhet vetëm për ato subjekte, vendimi i të cilëve është përfundimtar, i ekzekutueshëm ose për kërkesat që nuk janë trajtuar asnjëherë për kompensim. Të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuarat financiarisht si tokë truall, do të përfitojnë kompensim financiar nga fondi i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë. Ndërkohë, pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar do të kompensohet fizikisht nga fondi i tokës. Në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar për tokën truall rezultojnë se pjesa e mbetur është deri në 5 për qind më



e madhe se vlera 50 milionë lekë, atëherë subjekti kompensohet për të gjithë vlerën, në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar rezultojnë se pjesa e

mbetur është më e madhe se 5 për qind mbi vlerën 50 milionë lekë, atëherë subjekti për diferencën mbi 50 milionë lekë, kompensohet fizikisht, nga fondi i tokës.

KOMPENSIMI FIZIK

Agjencia e Pronës ka në zotërim 23 mijë hektarë tokë bujqësore, për të cilat ka përfunduar më herët edhe vlerësimi ekonomik, të cilat do të përdoren për skemën e kompensimit fizik. Për ndarjen e kësaj sipërfaqeje, dy do të jenë kriteret bazë. Kriteri i parë është rendi kronologjik i vendimeve, që do të thotë se, sikurse kompensimi financiar, edhe ky kompensim do të fillojë me vendimet më të vjetra në kohë. Kriteri i dytë lidhet me vendndodhjen e pronës që do të përfitojnë si kompensim fizik. Pra, pronari do të kompensohet me një pronë nga fondi

fizik, e cila gjeografikisht është më afër me pronën që i është njohur për kompensim. Në lidhje me dokumentet që duhet të depozitohen, ato nuk ndryshojnë, por mbeten të njëjta, si në rastin e kompensimit financiar. Ndryshon vetëm formulari i aplikimit, i cili është specifik për secilin rast. Në total janë 26 mijë vendime të formës së prerë, të cilat presin të kompensohen. Bazuar në ligjin e ri, Agjencia e Trajtit të Pronave ka nisur një proces të ri rivlerësimi, ku një metër katror tokë do të llogaritet me çmimet e tregut, por zëri kadastral nuk do të jetë ky i sotmi, por ai që ka pasur prona në çastin e shpronësimit.

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbimëri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	----------------------------	-----------

(Vijon nga numri i djeshëm)

Durrës	Vlash Bregu			
Durrës				
Durrës				
Durrës				
Durrës	Shefik Metalla			
Durrës	Murat Perhaj			3,883,500
Durrës	Agim Belegu			
Shkodër				
Vlorë	Thanas Ilija Duci			2,780
Durrës	Spiro Spiru			
Durrës	Spiro Spiru			
Gjirokastrë	Dhoske Ilija			
Durrës	Eleni Ekonomi			
Durrës	Pranvera Tufa			
Gjirokastrë	Jorgo Bili			EZAURUAR
Korçë	Tefik Kapllani			
Korçë	Asime Avdyli Braçe			EZAURUAR
Korçë	Hysen Shkurti			211,296
Shkodër	Gasper Darragjati			-
Shkodër	Bepin Kurti			-
Korçë	Aslan Memo			67,200
Elbasan	SHPETIM LAMÇJA			EZAURUAR
Korçë	Violeta Hatija			112,400
Lezhë	Ndue Figuri			
Vlorë	Llambro Ndonaj			
Vlorë	Syrja Aliaj			
Dibër	Ramazan Dishuka			
Elbasan	BAJRAM PEPA			1,155,900
Elbasan	ISUF CERRIKU			1,863,544
Elbasan	MAHMUT MUSA STAMBOLLXHU			EZAURUAR
Elbasan	FERDINAND SULA			44,674,000
Korçë	Luan Skoti			
Korçë	Enklid Shomo			
Korçë	Mitat Kacidhja			EZAURUAR

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbimëri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
Gjirokastrë	Isuf Kostreci			1,989,713
Korçë	Eftim Ziko			EZAURUAR
Shkodër	Sabah Troshani			6,905,995
Shkodër	Rustem Sykja			517,033
Shkodër	Jonuz Hoxha			5,549,242
Shkodër	Eqerem Piraniq			
Shkodër	Musa Gercari			-
Shkodër	Figuri Lika			1,711,220
Lezhë	Mark Gjon Nika			
Korçë	Feride Gjyli			
Korçë	Violeta Ziko			EZAURUAR
Durrës	Fatmir Hoxha			
Durrës	Haziz Kullli			
Durrës	Shpetim Hyka			
Durrës				4,041,599
Tiranë	ARET PINARI			
Tiranë	MUSTAFA SINA			EZAURUAR
Korçë	GJERGJI PALLOI			43,000
Durrës	Koco Nocka			
Durrës	Koco Nocka			961,415
Durrës	Koco Nocka			
Tiranë				4,848,556
Tiranë	SEFER MENERI			
Tiranë	NIKO DAMO			EZAURUAR
Tiranë	IBRAIM MENIKU			
Tiranë	IBRAIM MENIKU			
Tiranë				
Durrës	Ramazan Dedja			
Durrës	Hava Balla			
Durrës	Perikli Spiru			
Durrës	Adem Myftari			6,264,300
Durrës	Athanas Abraçi			
Fier	Tomor Hoxha			
Fier	Tomor Hoxha			EZAURUAR
Fier	Llambi Llupi			
Fier	Bashkim Shpata			8,393,549

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbimëri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
Lezhë	Preg Mark Prenga			
Lezhë	Zef Llesh Tusha			
Shkodër	Kel Zef Jaku			2,366,058
Shkodër	Dorotea Zoto			
Tiranë	MUHARREM METANI			3,648,000
Tiranë	XHEMAL SEFER HIDRI			EZAURUAR
Tiranë	MEHMET KASMI			19,354,041
Tiranë	MEHMET KASMI			36,832,950
Tiranë	GRIGOR REXHO			
Vlorë	Nuredin Çika			EZAURUAR
Vlorë	Nuro Hoxha			EZAURUAR
Elbasan	ALI DULLA			36,615,360
Durrës	Ismail Pumi			
Elbasan	ABDYLL ALBERT SHLIAKU			
Elbasan	PLATON GANI			
Elbasan	BEQIR SEJIDINI			14,349,300
Korçë	Nexhip Daut			
Durrës	Feride Dervishi			
Tiranë	AFRIM KAZAZI			15,369,386
Tiranë				EZAURUAR
Vlorë	Aristotel Kaçani			-
Vlorë	Panajot Vasili			
Vlorë	Olimbia Mia			-
Gjirokastrë	Theodor Kuleci			
Gjirokastrë	Feti Kondi			
Gjirokastrë	Hekuran Hoxha			260,100
Gjirokastrë	Tauilash Shehu			
Gjirokastrë	Dhimitraq Ballabani			3,631,824
Korçë	Qamil Panariti			
Gjirokastrë	Sofokli Cioelli			
Shkodër	Skender Cenaj			
Shkodër	Dan Semaj			
Shkodër	Gjergj Vlash Gocaj			1,512,512
Shkodër	Ernest Nush Gocaj			432,000
Tiranë	Fatmira Shquti, Feredin Shquti, Fitnete Sh			4,842,432
Tiranë	Anife Shala, Fazile Shala, Gezim Shala, Hys			542,850
Tiranë	GEZIM, FEZILE, ANIFE ETJ SHALA			542,850
Vlorë	Vangjel Krimidha			81,000

Korçë	Bashkim Maliqi		358,554
Shkodër	Feride Podgorica		3,715,792
Shkodër	Adnan Kallogjeri		9,582,832
Tiranë	AGIM KOKONOZI		
Tiranë	ABDULLA KARAJ		7,299,621
Tiranë	AISHE MEÇANI (SAMI)		-
Tiranë	XHELADIN CAUSHI		8,036,280
Tiranë	SANIE JARANI		3,803,839
Shkodër	Ndoc Thaci		1,829,865
Tiranë	Shuaip Llanaj		753,401
Tiranë	BEATRICE MANUSHI		11,049,885
Korçë			
Korçë			
Tiranë	SHAQIR PREZA		20,961,297
Tiranë			11,886,998
Tiranë	SANJE LUGA		42,391,377
Tiranë	THACI		
Tiranë			
Durrës	Zija Xhixhabesi		
Durrës			
Durrës	Agron Dobi		
Durrës	Ramazan Limanaqi		2,166,232
Elbasan	XHEZARE SENI		
Elbasan	Pasho Hida		3,793,238
Elbasan	ARIF CARCIU		
Elbasan			
Elbasan	HAJRIDE CANI		
Elbasan	SHEFQET XHAFERRI		
Elbasan	Qamil Guri		8,877,792
Elbasan	XHEVIT ZANI		
Elbasan	VELI ZANI		997,541
Fier	Halit Kajolli		
Korçë	Sazan Berberi		
Kukës	Lek Nika		
Shkodër	Llesh Brunga		
Shkodër	Trashg. Bushati		
Shkodër	Esher Duli		
Shkodër	Xhahid Bushati		2,272,437
Shkodër	Fiqerete Pipa		
Shkodër	Fiqerete Pipa		
Shkodër	Fiqerete Pipa		
Shkodër	Eqerem Lohja		
Shkodër	Vaide Koka		
Shkodër	Harun Berberi		
Shkodër	Nikoll Thani		6,553,470
Shkodër	Ixhial Sykja		
Tiranë	IBRAHIM XHAMEA	EZAURUAR	
Tiranë	IBRAHIM XHAMEA	EZAURUAR	
Tiranë	IBRAHIM XHAMEA	EZAURUAR	
Vlorë	Andon Trifoni		2,664,300
Vlorë	Mimoza Derolli		
Elbasan	SHAHIN BITROSHI		
Elbasan	NEZIR KARRIQI		3,303,749
Korçë	Hajdar Belli		698,240
Korçë			114,728
Korçë			206,976
Shkodër	Trash. Ejlli		69,500
Tiranë	MUHARREM HUQI	EZAURUAR	
Tiranë	ALI TIRANA		63,308,520
Tiranë			9,610,052
Tiranë	ATLIJE HEMA		
Tiranë	HAXHIRE BRAHJA (SHEHU)		15,134,994
Durrës	Hamit Deda		6,647,600
Durrës	Muhamet Sefa		210,705
Durrës	Vjera Killeca		425,258
Durrës	Kristo Dako		-
Elbasan	REFIK SINA		1,962,006
Fier	Zonje Harunaj		
Fier	Idai Sulaj	EZAURUAR	
Fier	Sabri Maraj		-
Korçë			4,157,519
Korçë	Viktor Cani		
Korçë	Halim Ombashi		450,000
Fier	Gjolek Shehaj		
Shkodër	Jak Gjonaj		1,123,452

Shkodër	Mynyr Avdia		2,701,283
Shkodër	Abdullah Miloti		-
Shkodër	Ibrahim Miloti		1,919,011
Shkodër	Angje Kadrija	EZAURUAR	
Tiranë	IBRAHIM XHAMEA	EZAURUAR	
Tiranë	ERVEHE GREPSA		50,210,008
Vlorë	Kalem Tasimi		
Durrës			
Korçë	Alma Bullaci		54,675
Tiranë	ALI NEVIRI		14,351,457
Tiranë	ALI NEVIRI		30,939,678
Vlorë	Faik Bataj		
Vlorë	Pajtim Çela		
Vlorë	Llazar Hoxharo		6,899,000
Lezhë	Llesh Bib Marku		
Lezhë	Zef Preng Kiku		
Shkodër	Pjeter Pashko Coha		
Shkodër	Enrik Kole Coha		
Vlorë	Spiro Bejler		554,676
Vlorë	Gjolek Brahimi		
Dibër	Qamil Gasa		
Shkodër	Muhamet Bajraktari		
Shkodër	Sabri Dibra		
Shkodër	Shygyri Tevia		
Shkodër	Vehid Ramadani		
Shkodër	Bashkim Teli	EZAURUAR	
Tiranë		EZAURUAR	
Tiranë	KUJTIM, AVENIR KIKA	EZAURUAR	
Tiranë	ALDO DELHYSA		14,905,004
Tiranë	YANGJEL HAXHINASTO		5,907,942
Tiranë	ARSINA KERKUSI (LASKU)		20,827,359
Tiranë	MUHARREM PEZA (HAXHOLLI)		
Tiranë	GANI LAMI	EZAURUAR	
Tiranë	KAMBER HOXHA	EZAURUAR	
Tiranë	AVENIR KIKA		
Tiranë	DHIMITER BERATI		75,166,006
Tiranë			
Tiranë	MIHAL KOJA		
Tiranë	ALBERT HANXHARI		
Tiranë	AVNI ZAJMI		
Fier	Isuf Klosi		
Fier	Kodhel Isufaj		
Korçë	Hasim Pulaha		
Korçë	Edmond Grabova		
Korçë			
Korçë	Dhimitraq Misha		
Tiranë	PERPARIM FARKA		
Tiranë		EZAURUAR	
Fier	Altin Vriani		
Kukës	Qazim Meshi		
Durrës	Xhevahire Marku		
Tiranë	SAIMIR DISHA		5,089,644
Tiranë	YANGJEL KOJA		8,371,125
Tiranë	YANGJEL KOJA		38,908,989
Durrës	Fiqrete Gorani		
Durrës	Bedri Kokomani		
Durrës	Bedri Kokomani	EZAURUAR	
Durrës	Bedri Kokomani	EZAURUAR	
Durrës			
Durrës	Lluka Rrufa		
Durrës	Lluka Rrufa		
Durrës	Xhevdet Mitruku		
Durrës	Ali Bardhi		
Durrës	Nazmi Hunda		
Durrës	Preng Coku		
Durrës	Preng Coku		
Durrës	Enver Lazimi		2,290,944
Durrës	Behixhe Karaboja	EZAURUAR	
Durrës	Yangjel Anastasiadhi		
Durrës	Shpati Dragoti		
Elbasan	PETRIT KARADAKU		7,211,660
Elbasan			10,185,672
Fier	Bardhyl Zazo		6,547,168
Fier	Barjam Hysaj		5,084,554
Fier	Bedri Strumi		

Shkodër	Trash Vokrrë		1,350,000
Shkodër	Trash Lisi (Kodheli)		
Shkodër	Ndue dhe Zef Ujka		460,000
Shkodër	Qemal Osmanagaj		1,650,105
Shkodër	Ruzhdi Duli		
Shkodër	Abdyll Boksi		7,651,389
Shkodër	Zef Bushati		-
Tiranë	BEXHET KOÇI		3,368,541
Tiranë	JONUZ SHIJAKU		4,553,892
Tiranë	SEFER KALLUSHI (KALOSHI)		3,013,605
Tiranë	IKBAL STERMASI		421,905
Tiranë	IKBAL STERMASI		2,343,915
Tiranë	HAMID ALIMEHMETI		19,220,103
Tiranë	HAMID ALIMEHMETI		1,988,979
Tiranë	HAMID ALIMEHMETI		803,628
Tiranë	OSMAN MENI		
Tiranë	GANI QAZIM HAJDARI		7,500,528
Tiranë	GANI QAZIM HAJDARI		3,013,605
Tiranë	SHABAN TUFINA		4,520,408
Tiranë	SHABAN TUFINA		4,393,166
Tiranë	SHABAN TUFINA		7,098,714
Vlorë	Agllala Bollano		
Vlorë	Haxhi Velaj		
Vlorë	Xhemal Mecaç		
Fier	Rustem Vriani		
Vlorë	Shpresim Kasaj		
Korçë	Myrvete Spaho		
Kukës	Rexhep Metalia		
Lezhë	Dila (Angelina Ndoj)		
Lezhë	Gjon Nikolle Gjuraç		
Tiranë	JORGJI HANXHARI		14,291,854
Tiranë	BAJRAM MALOKU		97,480,351
Tiranë	LEON LEZHA		52,972,479
Durrës	Vasil Gjergo		4,405,650
Durrës	Mustafa Rexha		
Durrës	Ahmet Godenca		
Durrës	Idriz Keja		
Durrës	Filip Gjonçi		1,163,370
Elbasan	ISUF BAKALLI		4,619,108
Elbasan	PELLUMB BELULI		382,920
Elbasan	ENVER DELIMETA		
Tiranë	XHEJE VERVALI	EZAURUAR	
Tiranë	QAZIM TOSKA		4,021,488
Tiranë	BEDRI MARA		2,109,524
Tiranë			1,674,225
Tiranë	IBRAHIM LULI	EZAURUAR	
Tiranë	IBRAHIM LULI		978,432
Tiranë	HATIXHE MUMAJESI		
Tiranë	PAVLI HOBDARI		2,558,216
Tiranë	ADEM KADIU		1,660,831
Tiranë	HALLI MUÇO		1,928,707
Tiranë	LUIGJINA, ROZMARI PRIFTI, KODHEL		18,751,320
Tiranë	OSMAN ALLA		2,966,057
Tiranë	OSMAN ALLA		3,281,481
Korçë	Aleksandër Karamitro		
Durrës	Idhomen Kosturi		
Durrës	Arap Toska		
Durrës	Francesk Brahja		
Gjirokastrë	Skender Ormeni		447,437
Elbasan	BELUL DOSKU		
Elbasan	HASAN ZENELI		487,891
Elbasan	HEKURAN RADICI		3,457,238
Gjirokastrë	Jorgo Proko		3,130,635
Gjirokastrë	Xhafer Ducellari		1,690,543
Gjirokastrë	Ardian Adhami		
Korçë	Muhamer Hoxhallari		
Korçë	Asime Ymeti		159,930
Korçë	Nuri Sulejmani		697,140
Korçë	Muhamet Xhull		
Korçë	Liri Sade		568,000
Korçë	Pellumb Berberi		124,272
Korçë	Teqi Kocibelli		734,000
Kukës	Shkurte Dauti		
Kukës	Uke Man Mekshiqi		2,059,200
Shkodër	Refik Bulaj		-
Shkodër	Ali Fresha		7,974,807

Tiranë	NAXHIJE JAUPI (DOMI)	
Tiranë	ABDYL JAUPI	EZAURUAR
Tiranë	SHAQIR KARABASHI	
Korçë	Hatixhe Progri	
Tiranë	HYSEN ISMAIL TUFINA	3,569,448
Tiranë	HYSEN ISMAIL TUFINA	997,838
Tiranë	HYSEN ISMAIL TUFINA	66,969
Tiranë	HYSEN ISMAIL TUFINA	1,747,891
Tiranë	ALBERT SAQELLARI	
Tiranë	RAKIP MINGA	15,402,870
Tiranë	RAKIP MINGA	19,889,793
Korçë	Bexhe Kolaneci	
Elbasan	TAIPE QYRA	
Elbasan	LAVER AHMATI	
Elbasan	HEKURAN ZENELI	2,276,826
Elbasan	SHEFQET CEKREZI	1,610,041
Elbasan	Hasim Shaliti	
Elbasan	Myfit Myftaraj	5,936,010
Elbasan	FETAH XHELILI	4,013,718
Elbasan	FAIL FEKA	762,737
Vlorë	Spiridhula Kacai	EZAURUAR
Dibër	LUAN REXHEPI	99,324
Dibër	SHKURTE CENI	250,060
Dibër	ALI GJECI	
Vlorë	Birac Shero	79,350
Vlorë	Olga Diamanti	
Elbasan	XHEMAL XHEPA	
Elbasan	IBRAHIM DAU	EZAURUAR
Elbasan	BESNIK SHISHMANI	638,200
Korçë	Neki Bylyku	EZAURUAR
Shkodër	Adli Zeka	6,664,113
Shkodër	Lec Cuni	-
Tiranë	ENVER SHEHU	5,397,414
Vlorë	Dhimiter Lako	
Vlorë	Afrim Agalliu	
Durrës	Lili Kyljeku	
Elbasan	ENVER COTA	1,990,596
Elbasan	HYSNI HASA	
Elbasan	HAMIT SADIK MOJSJA	EZAURUAR
Kukës	Ibish Metalia	
Berat	Hekuran Abas Sulejmani	4,065,760
Tiranë	HYSNI BABAMETO	35,202,255
Tiranë	SHPRESA BALI	935,803
Tiranë	QEMAL ETJ MURATI	6,094,179
Tiranë	OSMAN VAQARI	
Berat	Tasi Vrusho	
Kukës	Ibish Metalia	
Fier	Gjolek Hamataj	3,577,869
Fier	Bushi Lako	
Fier	Tatjana Zotaj (Ruka)	
Fier	Mehdi Prodani	6,168,252
Gjirokastrë	Vasil Tefa	
Korçë	Llazi Riza	
Korçë	Ferdinand Zhurka	
Korçë	Selami Sopoti	
Korçë	Maliq Osmanliu	160,000
Korçë	Shaban Tefiku	218,000
Korçë	Ferzilet Jalli	260,000
Korçë	Sali Çoçka	179,500
Korçë	Haki Ahmet	108,550
Korçë	Dhora Thomi	77,760
Korçë	Çelrike Myrtollari	441,800
Korçë	Shaqir Ustalli	
Korçë	Gaço Faço	
Korçë		550,000
Korçë	Avni Zaçe	
Korçë		556,310
Korçë	Ramadan Galla	
Kukës	Riza Muça	
Kukës	Azem Qausi	142,266
Lezhë	Pjeter Trumshi	750,000
Tiranë	SINAN HETA	20,827,359
Korçë	Dhimitraq Samara	
Shkodër	Shefike Sokoli	
Vlorë	Elvira Miho	-

Korçë		
Korçë	Vangjo Ilo	765,148
Korçë	Faredin Shellira	300,000
Durrës	Gazmend Feri	2,925,000
Durrës	Hysni Ferri	
Durrës	Reshit Barometa	
Tiranë	SKENDER METANI (MATANI)	21,049,002
Tiranë	RAMAZAN GALIP STERMASI	19,990,247
Tiranë	HIQMET MYZYRI	4,419,954
Tiranë	VANGJO RACI	22,769,460
Tiranë	SALI RAMA	
Tiranë	NURDIJE BRARI	30,598,136
Tiranë	NIKOLIN LACAJ	47,481,021
Tiranë		EZAURUAR
Tiranë	RAMAZAN SINA	EZAURUAR
Tiranë	BEQIR QOKU	26,318,817
Tiranë	BEDRI PETRELA	8,705,970
Korçë	Vangjo Kokoneci	1,020,000
Durrës	Meliha Tasim Tufa	
Kukës	Arif Xhafa	
Lezhë	Ndue Lesh Ndoka	220,447
Tiranë	ARIFE PASHO	143,628
Tiranë	IDRIZ XHAJA	375,690
Tiranë	REXHEP XHAJA	200,410
Tiranë	SHYQYRI HAJDARI	EZAURUAR
Tiranë	SELIM TAKU	1,158,400
Tiranë	ARBEN KOROYESHI	
Tiranë	ARTAN MINAROLLI	16,376,556
Tiranë	THOMA LALA	3,482,388
Tiranë	MARGARITA SEMINI (TERCA)	10,045,350
Durrës	Raqi Manasterli	
Durrës	Dhora Koraqi	
Vlorë	Vangelj Papa	EZAURUAR
Dibër	Shahin Tomja	
Dibër	XHELADIN ALI BEKTESHI	
Dibër	SHPETIM GJOKA	
Berat	ZAIM CAUSHI	
Korçë	Bujar Hamolli, Zenepe Hamolli	820,811
Korçë	Nesim Basha	421,098
Korçë	Hymyri Spahollari, Kadimije Spahollari, Ze	556,003
Korçë	Mesli Zeka, Minire Zeka, Nexhmije Zeka	315,096
Shkodër	Fatmir Dilaвери	
Tiranë	SADIK SHERA	EZAURUAR
Durrës	Agim Leka	
Durrës	Haxhi Zaza	
Durrës	Mitrush Minia	
Tiranë	Hasan Beqir Alla	EZAURUAR
Korçë	Faik Adem	155,627
Durrës	JORGJI MANUSHI	
Durrës	JORGJI MANUSHI	
Durrës	JORGJI MANUSHI	
Durrës	Maliq Bushati	
Durrës	Hajrie Shehu	
Fier	Veiz Siqueca	
Gjirokastrë	Tefik Goraj	701,720
Korçë	Teki Kaçoili	
Korçë	Dajlan Jupa	
Korçë	Estref Kaçoili	204,288
Korçë	Baftjar Laho	69,003
Korçë	Haxhi Kasko, Naim Kasko	275,328
Korçë	Pandi Gjika	EZAURUAR
Korçë	Illa Tili	
Korçë	Sali Mulla	
Shkodër	Cile Ceka	
Shkodër	Shefqet Sinani	3,080,196
Tiranë	MUHAMET SHKALLA	6,763,869
Tiranë	ADHURIM, AGIM MALE	
Tiranë	ADHURIM, AGIM MALE	6,562,962
Tiranë	IBRAHIM LALICA	8,237,187
Tiranë	ABDURAHMAN BEJTJA	30,437,411
Tiranë	SABAUDIN BOGDANI	EZAURUAR
Korçë	Lutfi Ibi	EZAURUAR
Tiranë	MYSLYM KURDARI	
Berat	Belul Çela	973,343
Gjirokastrë	Zariqi Shehu	EZAURUAR

Gjirokastrë	Hyske Ngjelina	
Elbasan	PRANVERA,MYZEJEN,BURBUQE ABDIHOXHA	
Elbasan	HEKURAN VELAKU	775,747
Elbasan	VEZIRE BEGA	
Elbasan	RAMAZAN LLESHI	1,161,181
Elbasan	Nebi Zeneli	
Elbasan	KULTI BEKTASHJAN	
Elbasan	Xhevahir Kullolli	431,784
Elbasan	ZENEL LLAPUSHI	
Lezhë	Nikolle Mark Deda	
Lezhë	Pjeter Ded Lleshi	3,290,250
Shkodër	Dede Gjon Markagjoni	
Tiranë		
Tiranë		
Tiranë	ADEM KORRA	3,214,512
Tiranë	REXHEP FAJA	6,629,931
Tiranë	REXHEP FAJA	21,430,080
Tiranë	REXHEP FAJA	34,689,942
Tiranë	QANI KARAKASHI	
Tiranë	RESHAT FAJA	8,572,032
Tiranë		16,139,529
Tiranë	IBRAHIM LALA	4,330,895
Tiranë	XHAVIT DRINI	40,171,815
Tiranë	AZIZ XHELADIN XHABAFTI	28,320,360
Tiranë	MEHMET DAUTI	11,250,792
Tiranë	BUJAR MARA	2,410,884
Tiranë	BUJAR MARA	14,030,006
Tiranë	MAHMUDIJE MUHAXHIRI	8,069,765
Tiranë	AGIM FERHATI	-
Tiranë	PAVEL KOJA	
Gjirokastrë	Stefanaq Juanidhi	
Gjirokastrë	Telat Ahmeti	158,565
Gjirokastrë	Muharem Dino	287,245
Gjirokastrë	Petraç Popli	
Gjirokastrë	Llambrihi Cela	156,125
Korçë	Zeme Gora	
Shkodër	Trash Hoxhaj	-
Shkodër	Zef Pjeter Fusha	2,794,500
Shkodër	Tom Lumci	270,900
Korçë	Nevrus Lika	
Fier	Nasi Bare	
Fier	Asqeri Balla	
Fier	Demir Ferko	8,131,520
Fier	Hysen Spahiu	2,514,662
Lezhë	Dava Ndue Legisi (Nikolli)	
Shkodër	Nestret Maliq Dermani	
Shkodër	Hamdi Bazhdari	330,021
Shkodër	Irfan Gjyzezi	
Tiranë	Hajrije Gjata (Demrozi), Natije Demrozi, Q	437,500
Tiranë	Emine Lecini, Emri Lecini, Feride Lecini, Fiqrete Lecini, Izet Lec	
Tiranë	Ramazan Vrap	1,974,000
Tiranë	Anife Xherri, Anife Xherri, Bajram Xherri, H	3,350,536
Tiranë	ISUF, HAXHI KOKOSHI	
Tiranë	MUHAMED XHELEZI	-
Tiranë		
Tiranë	FATIME,YMER ARKAXHIU	3,872,500
Tiranë	SEID TATAJ	EZAURUAR
Tiranë	ZENEPE CASLLI	EZAURUAR
Tiranë	XHEMAL VORPSI	24,443,685
Tiranë	MUSA DEMNERI	
Durrës	Kujtim Kasmi	
Durrës	Rexhep Molla	EZAURUAR
Vlorë	Shkëlqim Musaj	592,735
Vlorë	trashëgimtarët	
Durrës	Muhamet Sefa	
Vlorë	Dhionis Çili	2,823,877
Vlorë	Kujtim Kreshpa	
Lezhë	Ndue Gjok Kaçorri	
Durrës	Denis Zazani	
Durrës	Hysen Tepelena	
Durrës	Haki Kokomani	
Vlorë	Hamza Xhyheri	
Kukës	Elez Metalija	
Elbasan	SHEFQET MANA	
Fier	Mehdi Molosiu	4,983,200

Korçë	Hysni Shehu		
Korçë	Vasfi Staro		
Korçë	Adil Karafil		
Shkodër	Zef Nikoll Allaj		
Shkodër	Trash. Kaci		
Tiranë	ESAT KOTORRI	604,110	
Tiranë	ANDREA, VASIL KOSTRISA	5,886,200	
Tiranë	MYNEVERE VELIU	859,695	
Tiranë	MERJEME FORTUZI		
Tiranë	SEIT LEKA	26,988,507	
Tiranë	Emin Petja, Mehmet Petja	1,761,988	
Elbasan	ISLAM DERTILA	191,460	
Korçë	Shkendi Xhaqi		
Korçë	Ali Aliu	160,000	
Korçë	Stavri Jani		
Korçë	Avni Çoçka	120,000	
Korçë	Feride Mançe		
Korçë	Dilaver Dushku	313,159	
Korçë	Raqi Zguro		
Korçë	Minella Ballço		
Korçë	Minella Bicoll	158,400	
Korçë	Stavri Risto	276,700	
Korçë	Jorgjeta Melo	158,400	
Shkodër	Gani Kodra	2,151,248	
Tiranë	SHPETIM HYLVIU	10,781,040	
Tiranë	XHAVIT GJELL ETJ		
Tiranë	AISHE ETJ KANAPARI	6,242,470	
Tiranë		3,482,388	
Tiranë	SELMAN PETRELA	4,667,739	
Tiranë	SELMAN PETRELA		
Vlorë	Dhimiter Leka	9,600	
Vlorë	Thanas Süllo		EZAURUAR
Korçë	Isa Bliri	127,200	
Korçë	Taqo Gaqi		
Korçë	Aleksandra Sura	83,448	
Tiranë	MEHMET DAJA	9,107,784	
Elbasan	SHPRESA QAFLESHI		
Tiranë		51,934,460	
Tiranë			
Korçë	Hyrije Kulla		
Korçë	Gjergji e Petrika Çomo		
Lezhë	Gjon Molla		
Shkodër	Shuaip Duliqi	635,596	
Shkodër	Irfan Borici	3,574,005	
Shkodër	Asim Luli		
Tiranë	MUSA DEMNERI		EZAURUAR
Elbasan	BASHKIM CERMA		EZAURUAR
Elbasan	BASHKIM ARAPI		
Kukës	Fatmir Kastrioti		
Kukës	Rrushë Qema		
Elbasan	HAJDAR BANUSH BALLA	487,891	
Elbasan	GANI MEHMET KARRIQI	2,552,484	
Tiranë	MEXHIT URUÇI	815,424	
Tiranë	PETRIT URUÇI	1,563,305	
Tiranë	MEXHIT URUCI		EZAURUAR
Tiranë	SABIHA KASIMATI		
Durrës	Jakup Xherai		
Vlorë	Agim plaku	1,587,000	
Vlorë	Hajrulla Hajrullai	134,895	
Vlorë	Mynyr Idrizi		
Vlorë	Muharem Kuka		
Durrës	Maksim Gjokutaj		
Vlorë	Foto Gjika		
Durrës	Merjeme Zhupi, Nuriçe Toska, Shpresa Toto		
Durrës	Ilia Kuqi		
Durrës	Rukije Shehu		
Durrës	Jovan Stavri		
Durrës	Latif Emiri		
Durrës	Ramazan Kacani		
Durrës	Ramazan Kacani	4,168,500	
Elbasan	Abdyl Paralloi	4,926,904	
Elbasan	AHMET HASTOPALLI		

Elbasan	GEZIM BASHA		1,776,000
Korçë	Muhazes Bylykbashi		3,770
Korçë			472,645
Shkodër	Aslan Hoti		2,536,278
Shkodër	Qazim Kullolli		-
Shkodër	Mustaf e Isa Kadia		4,851,270
Shkodër	Mustaf e Isa Kadia		1,446,870
Durrës	Aishe Jaupi		
Vlorë	Ali Sula		2,040,000
Elbasan	Mahmut Qamil Peni		7,242,980
Kukës	Selman Metalija		
Kukës	Zenun Metalija		
Berat	Alush Musaj		269,979
Berat			
Berat	Myrteza Shinko		148,780
Berat	Bedri Bala		388,814
Korçë	Marjanthi Dhroso		615,038
Korçë	Sami Shupe		
Korçë	Llambi Kole		
Korçë	Gëzim Pepi		
Korçë	Batjar Seiti		44,385
Dibër	XHEMAL LAMI		
Dibër	BAJRAM KOLA		
Kukës	Nefail Mucaj		
Tiranë	FEJZULLA DALLIA		
Tiranë	MYSLIM BERBERI		1,502,530
Tiranë	DRITA MISRI		
Tiranë	Enver Veizi		
Tiranë	FETHI XHIHANI XHIHANI		23,235,000
Tiranë	NAIM XHIHANI		
Dibër	Muharrem Koxherri		
Dibër	Mexhite Dedolli		
Korçë	Maksut Maksuti		
Berat	Novrus Nurka		
Elbasan	FERDINAND HYSEN SARACI		1,366,600
Elbasan	MAHMUT STAMBOLLXHIU		
Elbasan	RAMADAN RIKA		1,557,999
Elbasan	AISHE JAHO		1,146,544
Elbasan	RIZA RIKA		1,099,382
Elbasan	SERJAN IBRAHIMI		1,506,857
Elbasan	SADIK HOXHA		1,332,299
Elbasan	IZET HOXHOLLI		3,386,448
Elbasan	XHEVDET GURI		5,138,709
Elbasan	NEKI POLE		1,141,803
Elbasan	ZABIT MEMA		
Fier	Hamza Myrtaj		
Fier	Ali Balla		
Fier	Fatmir Hoxha		3,232,279
Fier	Ylver Patosi		
Fier	Islam Xhema		4,065,760
Fier	Liri Capo		2,130,458
Fier	Ilmi Myftari		4,878,912
Fier	Rustem Çelo		
Fier	Haxhi Delibashi		9,757,824
Durrës	Ismail Subashi		
Durrës	Gëzim Dema		
Shkodër	Gazmend Llazani		
Tiranë	Emine Saraci, Fitnete Saraci, Nebi Saraci		
Tiranë	NEBI NASUFI		
Tiranë			1,148,868
Tiranë	HAJDAR LEMETI		1,144,920
Tiranë	REXHEP, ZENEPE ETJ PEZA		2,006,900
Tiranë	Naim Rrakli		
Tiranë	IZET KAZAZI		3,948,000
Tiranë	REXHEP SHIMA		
Tiranë	XHAVIT PLAKU		4,569,600
Durrës	AJAZI		13,080
Tiranë	BASHKIM BEKTESHI		
Tiranë	DHIONIS BECI		36,163,260
Durrës	Vlash Brisku		
Fier	Kamber Bregu		EZAURUAR
Shkodër	Lutfije Çukaj		

Durrës	Kozma Nina		EZAURUAR
Durrës	Fatos Tartari		-
Tiranë			
Tiranë			
Shkodër	Sose Fusha		
Korçë	THEMI NAQO		
Shkodër	Giuseppe Lanza		2,823,513
Shkodër	Agim Kraja		8,800,560
Shkodër	Agim Kraja		9,533,940
Shkodër	Trashg. Smaja		
Vlorë	Irma Zaho		EZAURUAR
Vlorë	Kisha Autoqefale Shqiptare		EZAURUAR
Fier	Lili Bare		
Fier	Seit Kanaj		
Dibër	ILIR SALLAKU		
Dibër	ILIRE, GANIMETE, HAMZA SALLAKU, RIZVANI, DEDJA		
Shkodër	Berhan Ademi		4,272,522
Shkodër	Berhan Ademi		14,638,920
Tiranë	ISLAM ALIMEHENTI		
Tiranë	FOTINI ZALLOTI		11,953,967
Tiranë	QERIME BLAKÇORI		20,693,421
Vlorë	Jori Bekari		EZAURUAR
Dibër	Kol Gjok Gjeçi		
Elbasan	Zenel Dermysbi		1,446,651
Fier	Yzedin Sulaj		1,219,760
Fier	Gani Avdullai		1,540,424
Fier	Fecor Beqiraj		
Durrës	Rexhep Selimi		
Durrës	Bejtulla Tepshi		
Durrës	Arjana Vasil Hametli		-
Durrës	Aqif Çelkupa		
Durrës	Vasil Gjergo		
Durrës	Vasil Gjergo		
Durrës	Ermira Kapuli		
Durrës	Xhemal Turku		
Durrës	Gjergj Qeraxhija		
Durrës	Rita Çuni		
Durrës	Hamza Muça		
Durrës	Hamdi Dervishi		
Elbasan	Selaudin Vyshka		
Elbasan	Ibrahim Vyshka, Kasen Vyshka		532,800
Fier	vero Lama		702,655
Gjirokastrë	Novruz Roci		
Gjirokastrë	Qazim Jace		674,152
Korçë			
Korçë	Hekuran Laçi		EZAURUAR
Korçë	Sotir Robo		39,600
Korçë	Gurali Ibrahim		131,400
Korçë	Lytfi Mersinllari		EZAURUAR
Korçë	Hamit Riza		
Korçë			568,000
Korçë	Nisret Kadriu		
Korçë	Arif Fazo		
Korçë	Bajame Hamolli		438,811
Korçë	Lirie Pambuku, Myfit Pambuku		EZAURUAR
Korçë	Gani Isallari		960,000
Korçë			185,399
Korçë	Mehmet Topi		188,076
Korçë	YLBER LAMCE		607,354
Lezhë	Mustafa Lama		29,874,507
Lezhë	Mark Bibe Nikollli(Zuku)		
Shkodër	Marije Biga		
Tiranë	ISUF DOBJANI		9,952,325
Tiranë	ENVER KAPIDANI		
Tiranë	Abaz Topi		1,758,115
Tiranë	IBRAHIM XHAMETA		-
Tiranë	IBRAHIM XHAMETA		
Lezhë	Preng Marku		
Korçë	Ferit Tahirlari		474,300
Kukës	Fatmir Metalija		
Gjirokastrë	Ollga Tite		
Gjirokastrë	Ana Barjami		
Kukës	Musa Aga		
Kukës	Imer Beg Hoxha		

DEBATI

Fatmira Nikolli

TEATRI KOMBETAR

Suela Bako: Kujtesa, tulla që mban në këmbë ngrehinën që po na shembet

Në këtë Tiranë kryeqytet duan të ekzekutojnë ngrehinën e vetme Kombëtare të Teatrit, me pretekstin e një teatri të ri modern?! Jo, është e patolerueshme". Suela Bako vjen në "GSH" në një intervistë ku si pjesë e trupës që po luan "Makbeth" në Teatrin Kombëtar, duket dhe sikur po i jep lamtumirë një teatri nga i cili dolën breza artistësh.

Si një njeri i lidhur me "të vjetrën", me traditën me historinë, Bakos i dhemb shumë që fëmijërinë e saj nuk e gjen më askund. "Kam ndërjet shumë dhimbje për Stacionin e Trenit, që u zhduk një ditë të bukur pa e vrarë mendjen kurrkush, edhe pse shumë prej nesh kemi lidhje emocionale me të. Po ashtu sheshi "Skënderbej", thotë aktorja. Në shfaqjen "Makbeth" ajo luan Malkolmin, princin që vjen në pushtet, me të cilin filozofia që Kleli Kzpxhiu ka dashur të nënvizojë dhe që sipas Suelës i flet kohës dhe vendit tonë shumë fort është: Froni i takon vrasësit më të mirë... Por kur ajo zhvishet nga roli dhe i duhet të heqë grimin e kostumit, kupton se t'i lësh lamtumirën godinës së teatrit "është ndjesi kaq e dhimbshme. Është si një fëmijë t'i marrin lodrën e preferuar".

- Si është të luash te "Makbeth", një shfaqje për pushtetin, shtypjen?

Është si të jetosh i shtypur dhe prej saj të mësosh të shtypesh dhe ta kthesh shtypjen në mjeshtëri. Cila është arma jote? - Vrasja, asgjësimi. Cili është synimi? - **Pushteti. Si e arrin këtë?** - Duke shtypur edhe bashkëpunëtorin më të afërt. Tek vizioni i Kled Kapexhiut, kjo është tepër e nënvizuar; nisur dhe nga personazhi që luan, Malkolm, princin që vjen në pushtet, filozofia që Kleli ka dashur të nënvizojë dhe që sipas meje i flet kohës dhe vendit tonë shumë fort është: Froni i takon vrasësit më të mirë... Këtë sprovë e kalon Malkolm i konceptuar nga Kleli, nën lëkurën e një aktoresje femër.

- Teksa ju jeni në skenë dhe shfaqja është premierë në TK, e ardhmja e godinës nuk dihet. A po i lini lamtumirën?

Pyetje e vështirë. Ajo për mua mbetet një kult besimi dhe dashurie. Kam pasur rastin të ngjitem në të, në 5 premiera dhe pastaj në shfaqje të veçanta shumë herë të tjera, është vërtetë e shenjtë, kjo jo për t'u bërë nostalgjik dhe as melankolik. Unë jam shumë e lidhur me "të vjetrën", me traditën, me historinë; më dhemb shumë që fëmijërinë time nuk e improvizoj dot gati

askund më. Kam ndërjet shumë dhimbje për Stacionin e Trenit, që u zhduk një ditë të bukur pa e vrarë mendjen kurrkush, edhe pse shumë prej nesh kemi lidhje emocionale me të. Po ashtu sheshi "Skënderbej", që merr forma nga më të ndryshmet sipas humorit në rastin më të mirë, apo interesave meskine në rastin më të keq. Gjithashtu për Pazarin e Vjetër që është bërë tepër i bukur, por që nuk nënkupton asgjë për atë që përfaqëson për kryeqytetin dhe historinë, e nuk po vazhdoj gjatë, se në fakt çdo gjë e rinovuar ha diskutim shumë, edhe pse ne si qytetarë të djegur për pastërti e rregull na zihen sytë dhe pëlqejmë edhe budallallëkun e parë që na zënë sytë, veç emër të një nevoje minimale jetese mes "rregullit dhe pastërtisë". Për t'u kthyer te pyetja juaj - ...Po! Duket se po ndahem me të përgjithmonë! Uroj të jetë një ëndërr e keqe...

- Si është ta shohësh një skenë ku ke kujtime të shkërmoqet para syve, ose të të thonë se nuk do ketë më as nam e as nishan?

Më duket se jam shprehur disi pak më sipër. Është ndjesi kaq e dhimbshme. Është si një fëmijë t'i marrin lodrën e preferuar.

- Keni qenë në shfaqje e role të ndryshme, në teatër e film - për Suelën sa e rëndësishme është kujtesa, tradita dhe liria për të thënë

Të luash "Makbethin" në teatrin që nuk i dihet e ardhmja, aktorja: E kam të vështirë t'i jap lamtumirën



Aktorja, Suela Bako

çfarë mendon e çfarë ndjen?

Me sa duket të kam paraprirë. Kujtesa në profesionin tonë është pikë kyçe. Kujtesa emocionale, kujtesa trupore, biologjike, historike... Ne jemi ca genie që funksionojmë në profesionin tonë falë, pikë së pari KIJTESËS! Pastaj sigurisht

kjo shoqërohet me formimin, përgatitjen, talentin, vullnetin etj., etj. Por është kujtesa, tulla, që na mban në këmbë ngrehinën, e cila po na shembet poshtë këmbëve. Unë për arsye që varen prej meje apo jo, më është dashur të punoj larg teatrit dhe të rikthehem tek ai plotësisht



përpara 5 vjetësh. Sigurisht që jam angazhuar sa herë kam mundur duke mbajtur gjallë atë pasion që më bëri sot të kthehem. Dhe ndihem kaq e humbur dhe e pafuqishme, që arsyet të cilat me bënë të tërhiqem rreth 20 vjet më parë janë njësoj të forta dhe shtypëse, madje më të egra tani. Për cilindo që mendon se kjo është patetike dhe thjesht një nostalgji, them që kjo është një vetëdije qytetare dhe profesionale ndaj profesionit dhe qytetit tim. Unë kam pasur rast të shoh teatro alternativë. Kam qenë në Greqi, Maqedoni, Broadway, Luksenburg, Francë dhe jam kaq e interesuar për këto salla alternative që shtetet e qytetet respektive kanë, por ato i kanë me shumicë dhe si t'i duash, një qytet me një popullsi prej 50 mijë banorësh ka më shumë teatro se sa ka Tirana sot dhe përkërisht në këtë

Tiranë - kryeqytet duan të ekzekutojnë ngrehinën e vetme Kombëtare të Teatrit, me pretekstin e një teatri të ri modern?! Jo, është e patolerueshme. Do të çmoja çdo lloj arkitekture moderne dhe shpikje arkitekturore që do të thotë diçka edhe për arkitekturën e qytetit tim, edhe për Teatrin, por kjo mund të jetë shumë mirë alternative, ose siç në botë kam parë - gërshtimin aq spektakolar të arkitekturës tradicionale me atë moderne, pa e prishur origjinalen, por vetëm duke i shtuar asaj funksionalitetin dhe lehtësirat. Ndërkohë, që Tirana ka shumë nevojë për të tjera ndërtesa artistike, të cilat janë kaq shumë të domosdoshme dhe uroj shumë që kjo dëshirë e mirë për të na qenë pranë, të vazhdojë të shtrihet në hapësirën e pakët publike të mbetur të qytetit tim. Në lidhje me lirinë, ajo është njësoj e shenjtë si teatri. Në kohën e para '90-ës, diktatura diti ta mbajë lart Teatrin se e kishte mbajt propagandë, ndaj dhe kujdeset për artistët (lexo: për pushtetin) ndërkohë, sot mesa duket, ata nuk duhen as si propagandë. Liria vritet çdo ditë që ti lufton me ekzistencën dhe me tavolinën e fëmijëve të tu... dhe kjo gjendje nuk erdhi brenda ditës, as brenda natës. Ka kohë që punohet për këtë liri të munguar...

Diskutimi për teatrin, 1 muaj sa 15 vjet

Nga Çapajev Gjokutaj

Këtë muaj është diskutuar shumë për teatrin. Mbase më shumë se 10-15 vjetët e fundit, marrë bashkë. Në fakt s'janë diskutuar premiera, koncepte regjisoriale, lojë aktorësh e të tjera "vogëlima" të këtij lloji. Është diskutuar për ngrehinën e Teatrit Kombëtar. Jetojmë apo jo në kohë komercializmi, kur materialja sfumoni e vuvs shpirtëroren? Lënë mënjë humorin, diskutimet për të ardhmen e ngrehinës dhe të trullit, për raportet privat-publik, për transparencën, korrupsionin etj., janë legjitime. Po mbase është me dobi që, ndonjëherë, të


flasim edhe për artin. Na bën mirë. Në mos për gjë tjetër, të paktën për shëndetin mendor. Nga mëngjesi në darkë dëgjojmë e lexojmë të flitet për politikë, korrupsion, vjedhje e vrasje. Overdozë negativiteti. Dikur, dekada të shkuara, premierat e Teatrit Popullor (Kombëtar) shënonin ngjarje, tërhiqin thuasje gjithë elitat e kryeqytetit dhe pasoheshin me diskutime të shumta në rrethe miqsh e shokësh, por, sidokudo, edhe në mediat e kohës. Sot vështirë të gesh informacion edhe për shfaqjet e javës, pa le më të kesh luksin të dëgjosh a të marrësh pjesë në diskutime. Pyetja "a ka rënë interesi publik për teatrin?", vjen e bashkohet me shqetësime të ngjashme edhe

për arte të tjera e për letërsinë. Dhe mes këtij shqetësimi zë e nxjerr krye nostalgjia: Dikur lexohej letërsi e përjetohej art, kurse sot kemi kafene e videolejera që do na dilnin e tepronin për tri jetë. Medemek "kjo botë u shthur...". Gjithsesi, kur i sheh gjërat më nga afër, pamja nuk rezulton të jetë kaq bardhë e zi. Vështirë të thuas se shqiptarët sot nuk janë aq pranë artit e letërsisë sa dikur. Aq më pak mund të thuas se kanë botë shpirtërore më të varfër, apo emocione më të mekura. Natyrisht, çdo kohë ka të vetat. Mediat audiovizive dhe interneti kanë hyrë tashmë në përditshmërinë tonë, kanë zënë një pjesë të saj dhe doemos kanë sjellë një rikon-

figurim edhe të marrëdhënëve që kemi me artet e letërsinë. Videot dhe lojërat e shumta, p.sh., vërtet që nuk janë art, por i kryejnë për bukuri disa funksione të tij si argëtimi, harrimi i vetes, ikja në realitet të përfytyrurara etj. Si të tilla konkurrojnë me artin, sidomos me llojet pop të tij. Rrjetet sociale i kanë dhënë fund monopolit të elitave në ligjërimin publik. Nivelet e poshtme të lexuesve dhe spektatorëve kanë tashmë mundësinë të vetëshprehjen, të përcjellin qëndrimet e tyre në publik. Ndaj janë shtuar si kurrë më parë artikullimet për kulturën pop, "showbiz"-in etj. Doemos kjo i zvogëlon hapësirat e artit elitare ose, më së paku, tërheq

vëmendjen në nivelet e poshtme. Hollywood-i, Broadway, premierat nga Londra, Parisi, Moskë, Sidnei etj. vijnë e hyjnë drejt e në dhomat tona të ndenjes. Me platforma të tipit Kindle mund të blesh e të lexosh libra e revista që posa dalin në metropolet botërore. I gjendur mes këtij vërshimi global librash, filmash, premierash, shqiptari i sotëm doemos që nuk mund të ketë etjen dhe kureshtjen e dikurshme për premierat e TK apo promovimin e krijimeve vendase. E megjithatë, njeriu është programuar të ketë nevojë për gjuhën, letërsinë, artin e vendit amtari, sepse gjithmonë ka pasur e do të ketë nevojë për identitet, ashtu si pema për rrënjë e shtëpia për themele.

E DIEL
25 Mars
2018



SI E KA ZBËRTHYER IMAZHI KULTUROR SKËNDERBEUN!

NGA DR. ARIOLA PRIFTI

Cdo komb ka një Hero Kombëtar. Por rrallë i ndodh një vendi kaq të vogël si Shqipëria të ketë për të tillë, një figurë si Gjergj Kastrioti Skënderbeu (6 maj 1405 – 17 janar 1468). Vlera më e lartë kombëtare e figurës së tij është se për 25 vjet ai mbajti larg Shqipërisë ushtrinë turke, duke e thyer pothuajse në çdo betejë. Janë të shumta betejat e fituara nga Skënderbeu së bashku me ushtrinë e tij.

Vlerat e figurës së Skënderbeut janë ndërkom-bëtare, duke qenë se ai u bë prijësi i barrierës ndaj ushtrive turke për pushtimin e Evropës dhe mosshtrirjes së fesë islame në kontinentin evropian. Barleti në veprën e tij "Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut", flet për karakteristikat trupore dhe vizaton portretin fizik të Skënderbeut, diku për cilësitë e mendjes dhe të zemrës, diku tjetër për sjelljet e tij ndaj ushtarëve ose kundërshtarëve.

Skënderbeu shquhej së pari dhe admirohej për tiparet e tij trupore. Këtë admirim dhe dashuri ai e pati që kur ishte peng në oborrin e Sulltanit. Bukuria e trupit dhe hijeshia e gjymtyrëve, shtati i lartë dhe qafa e fuqishme, ia rrisnin shumë virtytet e tjera dhe dukeshin se ia shtonin mirësitë e shpirtit. Sipas konceptit klasik të grekëve të vjetër, trupi i bukur dhe i fuqishëm është pasqyrë e bukurisë dhe e fuqisë së shpirtit, të mendjes, të ndjenjës dhe të vullnetit. Skënderbeu mishëron çdo gjë të lartë, të bukur të fuqishme, të madhërishe.

Që në moshë të vogël Skënderbeu digjej dhe bluan-te në mendje plane për gjëra të mëdha. Ai kishte fuqi shpirtërore të pamposhtur, po aq sa edhe trupore dhe ve-pronte shpejt e nuk përkulej para asnjë vështirësie, nuk donte t'ia dinte as nga të ftohtit, as nga të nxehtit. Gjergj Kastrioti Skënderbeu ishte i dashur për karakterin e tij popullor. Ai i donte ushtarët me gjithë zemër, ai u shkonte kokë më kokë, kur plagoseshin dhe kujdesej për ta si ndonjë shok i thjeshtë i tyre.

Barleti tregon në veprën e tij sesi njëherë Skënderbeu pasi kishte luftuar me armikun kishte dhënë urdhër ushtarëve të tij të shko-



nin në një luginë që banorët e qanin "E Bukura" dhe atje kishte dhënë urdhër të ngulnin flamurët dhe të qendronin gjersa të çlod-heshin ushtarët, të riformoheshin më drejt, nën dritën e diellit, radhët e tyre dhe të mund të merreshin masat për kujdesin e të pla-

gosurve, të cilëve, ai duke lënë më një anë madhësinë e kapedanit, me natyrën e tij prej ushtari, u shkonte pranë, i ngushëllonte një për një dhe i fërkonte me dorë, sikur të ishin të vegjël. Për këtë arsye edhe ushtarët e donin sa qanin për të. Karakteri popullor i

Skënderbeut u pëlqente edhe armiqve. Skënderbeu ishte mënd-jelartë e mëndjehollë, me shpirt të madh e të fortë, i urtë e i përmbaj-tur sa s'ka. Skënderbeu e përmbante veten edhe në zemërimin më të madh. E madhërishe ishte sjellja e Skënderbeut për butësinë

e shpirtit të tij akoma edhe kun-drejt armikut të mundur. Zotësinë luftarake Skënderbeu e tregoi në të gjithë taktikën e luftës, taktikë e re, për të cilën e admironin edhe armiqët.



Vijon në faqen 14

Në këtë numër: DR. ARIOLA PRIFTI, RUDOLF MARKU, MIROSLAV ÇURÇIÇ, DR. ZEJNEPE ALILI REXHEPI, QERIM VRIONI...

I IMAZHI

Për Heroin tonë Kombëtar dhe për epikën e tij janë shkruar dhe i janë përkushtuar vepra të shumta narrative e janë thënë me dhjetëra legjenda dhe tradita lokale. Vlerat e figurës së Skënderbeut janë ndërkombëtare. Nga personalitete të huaj, nga historianë të huaj, ai është vlerësuar me epitete të tilla si "Atlet i Krishtit" dhe "Ideatori i Aleancës së Parë Euroatlantike". Epitete këto që e ngrenë shumë lart figurën e Heroit tonë Kombëtar. Sot në botë emrin e Gjergj Kastriotit Skënderbeut e mbajnë sheshe të shumta në kryeqytete dhe qytete të rëndësishme, duke filluar që nga Tirana, Prishtina, Shkupi, Parisi, Roma, Michigani, etj. Buste dhe shtatore të Skënderbeut po ashtu janë vendosur dhe priten ende të vendosen, në shumë vende të tjera...



Monumenti i Skënderbeut mbi kalë.
Sheshi "Skënderbej", Tiranë



Monumenti i Skënderbeut mbi kalë.
Prishtinë



Monumenti i Skënderbeut mbi kalë.
Shkup

Gjergj Kastrioti Skënderbeu, zotësia e tij luftarake dhe përfaqësimi i tij artistik

NGA DR. ARIOLA PRIFTI

Vijon nga faqja 13

Gjergj Kastrioti Skënderbeu u fliste me pasion ushtarëve për taktikën para çdo ndeshjeje dhe dëshiron që ushtarët të ishin të bindur për këtë gjë.

Skënderbeu e parashtron, rëndësinë e taktikës së tij që në mbledhjen e Lezhës, duke e konsideruar si një nga kushtet themelore që do të sigurojnë fitoren kundër turqve.

KARAKTERI POPULLOR I GJERGJ KASTRIOTIT SKËNDERBEUT

Por taktika e Skënderbeut e ka forcën e saj dhe bazën e suksesit sidomos në karakterin e vetëdijshmërisë në gjithë masën e ushtarëve, në faktin se ajo, para se të vihej në praktikë, u bëhej e njohur ushtarëve, shoshitëj e pranohet me bindje prej tyre, sepse Skënderbeu nuk vepronte kurrë pa u këshilluar me shokët e ushtarët e tij.

"Unë s'jam nga ata", u thotë ai ushtarëve, "që të tërheq njerëzit në rreziqe, pa ditur se ç'bëjnë" ai sh-ton se." Unë kam dashur që, përpara se të vë në zbatim ndonjë mënyrë të re në këtë luftë, të flas më parë me ju dhe të di mirë vullnetin e secilit, kështu që ose unë të vij pas mendjes suaj, ose ju pas sime". Zotësinë dhe trimërinë e Skënderbeut e njihnin mirë edhe turqit.

HEROI YNË KOMBËTAR DHE PËRFAQËSIMET E TIJ ARTISTIKE

Për Heroin tonë Kombëtar dhe për epikën e tij janë shkruar dhe i janë përkushtuar vepra të shumta narrative e janë thënë me dhjetëra legjenda dhe tradita lokale. Vlerat e figurës së Skënderbeut



Monumenti i Skënderbeut mbi kalë.
Krujë

janë ndërkombëtare. Nga personalitete të huaj, nga historianë të huaj, ai është vlerësuar me epitete të tilla si "Atlet i Krishtit" dhe "Ideatori i Aleancës së Parë Euroatlantike". Epitete këto që e ngrenë shumë lart figurën e Heroit tonë Kombëtar. Sot në botë emrin e Gjergj Kastriotit Skënderbeut e mbajnë sheshe të shumta në kryeqytete dhe qytete të rëndësishme, duke filluar që nga Tirana, Prishtina, Shkupi, Parisi, Roma, Michigani, etj. Buste dhe shtatore të Skënderbeut po ashtu janë vendosur dhe priten ende të vendosen, në shumë vende të tjera. Në pjesën më të madhe të punimeve artistike, Heroi Kombëtar qëndron hipur mbi kalë duke simbolizuar luftëtarin. Kali i Skënderbeut është një tjetër simbol që ka shoqëruar heroin tonë Kombëtar. Sipas Barletit, kali i tij ishte i bardhë dhe i përkiste një race të zgjedhur. Madje gojëdhënat tregojnë se pas vdekjes së Skënderbeut, ai nuk pranoi t'i hipte njëri tjetër dhe pas kësaj ai ngordhi.

Dy janë uniformat që ka përdorur Gjergj Kastrioti Skënder-



Pilakatë në Sheshin "Skënderbe", Paris

beu. E para ishte uniforma e luftës, me përkrenare dhe parzmorë, ndërsa veshja tjetër që përmend Barletit është ajo popullore me qeleshe dhe xhubletë.

SHESHI DHE KUPTIMI I TIJ

Sheshi, në rrugën imagjinare të kujtesës, është vendosur gjithmonë në qendër të një sistemi kompleks dhe të ndërlikuar shenjash urbane, ku në të përmblidhen në të njëjtën kohë burimi dhe zgjidhja. Qyteti është gjenuar nga një vakum apo hapësirë e dedikuar dhe e përcaktuar, dhe kompleksiteti i saj shkrirhet ose shpaloset në shesh, është pika e mbarimit dhe qendra e rrugës gjarpërore apo la-

birintike. Sheshi është një hapësirë e përfutur nga një zgjidhje e vazhdueshmërisë së të punuarit, një qendër force, e një potencialiteti të pasqyruar apo të shprehur në një nivel të ndryshëm, shpesh e përcaktuar dhe e karakterizuar nga një pjesëmarrje e një objekti të veçantë arkitektonik të një rëndësie të caktuar (si kishë, monument, pallat mbretëror, muze, shtatërvan etj). Ajo paraqet gjithashtu një shenjë të prekshme të një fuqie e cila nuk mund të mos lërë gjurmë të dukshme. Ashtu si qyteti tokësor nuk është gjë tjetër përveçse pasqyrë e paqartë dhe e pasaktë që i referohet grimcave të dritës dhe të lavdisë së Qytetit Qiellor. Sheshi është një metaforë e zemrës, ose e qendrës së shenjtë nga të cilat rrezatojnë ndikimet shpirtërore, hapësira e përfunduar, paraqisja në mesin e të cilës është vendosur Pema, simboli polar kozmik, e cila është rritja, ngjitja, imazhi dinamik i botës, emblema e jetës shpirtërore. Pra sheshi, qendra e krijimit dhe terreni i materializuar, reflektimi tokësor i asaj shpirtëror, është vendi në të cilin kanë bërë marrëveshje të gjitha rrugët e botës, destinacioni i pandërprerë i pelegrinazhit të njerëzve në kërkim të parimit të pandryshueshmërisë, burim i së vërtetës dhe shpëtimit. Brenda rrjetit të rrugëve dhe shtresave që përbëjnë planin territorial, sheshi përfaqëson hapësirën në të cilën shprehet jeta kolektive pra forma urbane në të cilën çdo shoqëri ka përfaqësuar vetveten. Sheshi për këtë arsye mund të përkufizohet si një trashëgimi kulturore e ndërmjetme, ndërmjet monumentit të vetëm dhe vazhdimësisë urbane, duke grumbulluar funksionet dhe qëndrimet publike kontradiktore me jetën private të ndërtesave dhe pallateve të banuara.


Sheshi me karakter zyrtar apo

monumental, vendi i pushtetit dhe i paradave, por edhe hapësira ideale, sheshi ka qenë gjithmonë objekt i ndjenjave kontradiktore, sipas kuptimeve të ndryshme që i atribuohen atij. Për këto arsye sheshi është një pikë e rëndësishme reflektimi duke marrë parasysh dhe duke analizuar ndryshimet që ky objekt pëson në kohëra të ndryshme historike duke qenë i lidhur ngushtë me sjelljet dhe ndërveprimet e ndryshme të banorëve, gjatë shekujve.

MONUMENTI I SKËNDERBEUT NË "SHESHIN SKËNDERBEJ", TIRANË, SHQIPËRI

Kur flasim për fjalën Shesh, menjëherë na vjen në mendje "Sheshi Skënderbej", i cili është sheshi qendror i Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë. Ky është sheshi më i madh i Shqipërisë me një sipërfaqe afërsisht 40 000 m².

Sheshi e mori këtë emër në nderim të Heroit Kombëtar Shqiptar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe është vendi simbol jo vetëm i kryeqytetit por i të gjithë shqiptarëve, që me sipërfaqen e tij përfaqëson më së miri qendrën gjeografike dhe politike të Shqipërisë. Fokusi i këtij sheshi është përqendruar në statujën madhështore kushtar Heroit Kombëtar. Monumenti i Skënderbeut mbi kalë në Tiranë u vendos më 1968. Ky monument është vepra e skulptorit Odhise Paskali në bashkëpunim me artistët Andrea Mano dhe Janaq Paço. Ai u vendos më Tiranë me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së heroit kombëtar. Ky shesh u konceptua fillimisht të qendrën historike të Tiranës nga Mbreti Zog I në bazë të stilit arkitektonik neo-racionalist, ajo u zgjerua në vitet ndërmjet 1920-1930 nën diktaturën fashiste të Mbretërisë së Italisë. Më pas, në



...NGA NUMRI I SHKUAR

Në këtë numër të fundit patëm një vërejtje të drejtë të antropologut Albert Doja, lidhur me shkrimin e tij. Pjesa kryesore dhe propozimi im i bërë në Harvard lidhet bash me fundin dhe më duket se e keni ndërprerë në mënyrë arbitrare, na u ankua me të drejtë. Profesor Doja jo vetëm kishte të drejtë, por i kërkojmë sinjerisht falje. Jemi të detyruar në morinë e shkrimeve dhe të hatërmbetjeve, që të mbajmë ekuilibra që jo rrallë na kanë rezultuar edhe me gabime. "Në kundërshtim me pikëpamjet e deritanishme, një lexim më i kujdesshëm dhe një analizë kritike më sistematike e të dhënave demografike, burimeve historike dhe dëshimeve etnografike tregon qartë se familja shqiptare është përbërur për një kohë të gjatë me nivele veçanërisht të ulëta të lindshmërisë dhe me një moshë mesatare relativisht të lartë në martesë për

gratë. Një qasje më analitike e modelit organizativ segmentar të grupimeve agnatie paralele në shoqëritë e Evropës Juglindore, duke përfshirë Shqipërinë, mund të zbulojë gjithashtu se struktura segmentare e organizimit shoqëror është e papërshtatshme për të mbështetur supozimin e një familjeje të zgjeruar patriarkale", shkroi ai dhe e shtjelloi.

Redaktori në këtë numër shtoi një shkrim për propozimin e dikurshëm të arkitektit Maks Velo për një xhami moderne në Tiranë në vend të xhamive tipike arkaike që po mbajmë. Shkrimi ka pasur tepër tërheqje dhe shumë interesim sidomos nga komuniteti mysliman. Presim që të rrethohet dhe sharjet e zakonshme.

Ndërkohë që redaktori bëri një këndvështrim tjetër për teatrin e ri dhe sensin që kryeministri i vendit dhe shpura e tij duhet të ishin më transparentë, që të eliminojnë këtë katrohrë të nodhur. Për fat

edhe ky shkrim është pritur mirë, por një pjesë e përkrahësve të z.kryeministrit nga titulli e kuptuan se ishte në mbështetje pa kushte të idesë së Ramës. Për të bërë një paralelizëm të bukur na erdhi një përkthim. Një autor i huaj shpjegonte sesi Londra në kohën e Shekspirin me banorë sa Tirana në vitin nëntëdhjetë, kishte dhjetë teatro, ndërsa Tirana sot me një milion banorë, po tenton t'i shpëtojë një debati të madh për teatrin. Fragmenti ishte përkthyer nga libri i M. Morozovit: "Shekspiri".

Enton Bido na solli një përkthim nga FRANCE DIPLOMATIE për Jean Marie Gustav Le Clezio, i cili zë një vend të veçantë për sa i përket të grupeve, shkollave, modave. Francez dhe maurician i rritur me kulturën frënge dhe njohës i hollë i letërsisë anglo-saksone, ky romancier i jashtëzakonshëm mburret me Lotremonin, Zola'n, por gjithashtu me Stivenonin dhe Xhojsin.

Kritika gjithnjë ka hequr keq ta ngacmojë, ta kufizojë në ndonjë përcaktim të veçantë, e përkufizonte autori i intervistës.

Në këtë numër botuam një cikël të Demir Gjergjit, që mbeti i kënaqur por pati dhe pak vërejtje brenda maturisë së tij, që duhet vlerësuar. Ky cikël me poezi sjell krijimtarinë e autorit Gjergji në ditët tona. Ka disa koha që fle në arkivin tonë, ndërsa e sjellim në të gjithë përbërjen e vet për publikun. Autori është një lirik i paqta, që mundohet edhe trishtim ta mbajë në një regjistër të pranueshëm

Kurse doktor Pandeli Çina na solli një cikël të shkurtër me krijatet e letërsisë polake dhe arrijt e mira të autorëve Shimborska dhe Zagajevski. Ishte përgjithësisht një numër i mirë dhe shumë i këndshëm.

periudhën komuniste (1944-1990), u rimodelua sipas kërkesave të regjimit të afërhershëm. Ndryshimet e fundit në këtë shesh u bënë gjatë viteve 2016-2017. Aktualisht ky shesh sjell një impakt më ndërveprues me njeriun dhe bëhet simbol i jetës së përditshme të tij. Është vendi dhe hapësira shplohëse dhe gjithashtu pika e takimit për qytetarët jo vetëm të Tiranës por të gjithë Shqipërisë.

Sheshi rrethohet sot nga Banka Kombëtare e Shqipërisë (1936), Muzeu Historik Kombëtar (1981), Hotel Tirana International (1979), Pallati i Kulturës (1960), Kulla e Sahatit (1821), Xhamia e Ethem Beut (1823), Bashkia e Tiranës (1920), Teatri Kombëtar i Fëmijëve (1920).

MONUMENTI I SKËNDERBEUT NË KRUIJË, SHQIPËRI

Monumenti i Skënderbeut në Krujë është një veepër e skulptorit Janaq Paço. Kjo skulpturë monumentale u përuhua më 28 nëntor të vitit 1959. Ndodhet në qendër të qytetit të Krujës dhe është statuja e parë monumentale e ngritur në Shqipëri.

MONUMENTI I SKËNDERBEUT NË PRISHTINË, KOSOVË

Monumenti i Skënderbeut në Prishtinë u përuhua në vitin 2001. Autor i këtij monumenti është skulptori Janaq Paço. Materiali i kësaj skulpture monumentale është bronzi i derdhur. Si një nga të paktët, sot, arti i këtij artisti tregon mbi të gjitha anën njerëzore të tij. Shprehja e parë, e cila na vjen nga çdo skulpturë e tij, është me energji. Një energji karakteristike, plot me duf. Në bazë të saj ndihet ajo ndjeshmëri akute dhe e shqetësuar e një njeriu modern, e cila torturon, dhe duket se godet: por është edhe e zbutur nga inteligjenca dhe vullneti.

Feja, atdheu, heroizmi, janë ndjenjat që, shkallë shkallë, në bazë të zhvillimit të frymës së tij, mbizotërojnë në frymëzimin e saj, e cila manifestohet më pas gjithmonë me plotësinë e njeriut dhe me forcën e bindjes që nuk lindin ndryshe përveçse kush ka përvojë të madhe të saj.

MONUMENTI I SKËNDERBEUT NË SHKUP, MAqedoni

Monumenti i Skënderbeut në Shkup është i derdhur në bronz dhe peshon 2,7 tonë, ndërsa së bashku me bazamentin është i lartë 7 metra. Kjo njëkohësisht e bën atë dhe shtatoren më të lartë në Maqedoni, veepër kjo e skulptorit Thoma Thoma. Luftëtari, i mbyllur në një



Monumenti i Skënderbeut, Romë



Monumenti i Skënderbeut, Michigan

armaturë solide, me përkrenarën mbi kokën e tij dhe shpatën e ngjeshur, është paraqitur në një kalë të guximshëm që përparon me hapin në ecje. Nga kjo veepër duket se buron një fuqi dhe një forcë e përgjenduar.

Gurthemeli i bazamentit ku qëndron monumenti i Skënderbeut në Shkup u vendos më 28 nëntor të vitit 2005. Ndërsa monumenti u parë më 28 nëntor 2006.

MONUMENTI I SKËNDERBEUT NË SHESHIN "ALBANIA", ROMË, ITALI

Sheshi Albania është një shesh në Romë i vendosur përgjatë Krugës Aventino. Jo shumë larg Porta San Paolo, në afërsi të kodrës Aventino. Sheshi u ndërtua me planin rregullues të vitit 1883, i cili përfshinte ndërtimin e të gjithë kodrës Aventino, zgjerimin e ndërtesës në Testaccio, në rrugën Marmorata dhe në lagjen San Saba. Bëhej fjalë për një zonë, e cila ishte shumë pak e banuar deri në atë periudhë kohore, gjë që bëri të mundur gjurmimin pothuajse të drejtpërdrejtë nga rruga aktuale e Aventinës. E quajtur në fillim Sheshi Raudusculana, sepse ishte vendosur aty ku më parë ishte Porta Raudusculana, sheshi ndrysoi emërtimin e saj më 4 korrik 1940, duke u bërë Sheshi Albania, për të përkujtuar aneksimin e Shqipërisë në Mbretërinë e Italisë, që u reali-



Sanxhaku i Shqipërisë në vitin 1313

zua nga ato një vit më parë. Në këtë shesh gjenden ndërtesa të ndërtuara midis viteve 1930 dhe 1960 dhe monumentin me statujën e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, Heroi Kombëtar shqiptarë. Kjo veepër është realizuar nga skulptori italian Romano Romanelli. Në monografinë e tij të vitit 1924, studiuesi italian Mario Tinti përkufizoi skulpturën e Romanellit "statike dhe euritike, gjeometrike dhe gravitacionale, të zbritura nga ambienti i mjedisit atmosferik, i mbyllur plotësisht në vetvete dhe në armaturën e tij stilistike,



Medalja e Skënderbeut në bronz, Biblioteka Kombëtare Paris



pothuajse për të ruajtur më mirë mungesën e shpirtit njerëzor nga të gjitha rëniët dhe kontingencat.

Ndërmjet dhjetorit të vitit 1466 dhe pranverës së vitit 1467, Gjergj Kastrioti Skënderbeu erdhi për herë të tretë në Itali për të kërkuar ndihmë nga Papa Pali II. Aty, ai qëndroi tek një tregtar epirot, në një pallat pranë Shtatërvanit të Trevit, në sheshin aktual Skënderbeu, një nga të parët në Romë që mban një emër të huaj. Në bazamentin e këtij monumenti është shkruar një mbishkrim në vitin 1968 nga Bashkia e qytetit të Romës me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Prej 23 tetorit 1930, Romanelli mori titullin akademik i Italisë. Në vitin 1932 realizoi, për Kullën e Revolucionit në Brescia, monumentin me Musolinin mbi kalë, e cila risolli në solemnitetin e formës së saj rivendosjen e punimit për Sheshin Albania në Romë. Por ky monument u hoq në fund të Luftës së Dytë Botërore dhe fatkeqësisht u zhduk.

MONUMENTI I SKËNDERBEUT NË MICHIGAN, AMERIKË

Prej pak kohësh, është vendosur dhe përuarur një monument i Heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut, në Michigan të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky monument është vendosur në një nga vendet që shqiptarët kanë zgjedhur dhe janë vendosur të jetojnë prej vitesh atje, pra në Michigan. Kjo është statuja e parë e dedikuar Skënderbeut në Shtetet e Bashkuara, në kodrat Rochester. Monumenti është i pozicionuar pranë ndërtesës së kishës shqiptare të Shën Palit, e cila u themelua në vitin 1981 nga disa emigrantë shqiptarë, shumë prej të cilëve ishin vendosur në kontinentin Okland gjatë viteve 1970.

SHeshi "SKËNDERBEJ" NË PARIS, FRANCË

Sheshi Skënderbeu është një rrethrotullim i vendosur në rrethin Pont-de-Flandre të rrethit numër 19 të Parisit mbi rrugën anazore të Bulevardit periferik. Pas një përpjekje rreth 10 vjeçare të Isa Ndreut dhe Lec Shllakut po edhe të Mërgatës antikomuniste, u bë e mundur nga Bashkia e Parisit që më 1978 të merrej leja që njeri nga sheshet e Parisit t'i vihej emri i Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Në atë kohë Kryetari i Bashkisë së Parisit ishte z. Zhak Shirak, i cili më vonë u bë President i Francës. Në 6-7 maj 1980 u bë një manifestim madhështor mbarëshqiptar i diasporës, ku erdhën shqiptarë nga e gjithë bota

ku jetonin si nga Kanada, Shtetet e Bashkuara, Australia, Zelanda e Re, po edhe nga Europa, e në veçanti Arbëreshët e Italisë të veshur me kostumet e tyre tradicionale 5 shekullore, që i dhanë ngjyrë kësaj feste shqiptare në Paris. Morën pjesë shumë personalitete të shumta të historisë, artit, kulturës, klerikë por munguan përfaqësuesit e ish shtetit të dikurshëm totalitarist shqiptar. Ky shesh, është shumë pak i njohur dhe janë të pakët ata shqiptarë që e dinë se ky shesh ndodhet në Paris në kryeqytetin Francez. Organizatorët në atë kohë menduan, se ky shesh do ti shërbente diasporës shqiptare me qëllim që të mblidhej të paktën një herë në vit ditën e 28 Nëntorit, e të përkujtonte Nëntorin e lavdishëm si 28 Nëntorin e Krugës dhe 28 Nëntorin e Vlorës. Por kjo nuk ndodhi.

Me rastin 10 vjetorit të festimit të kësaj dite u përgatit në broz Medalja e Skënderbeut nga Isa Ndreu.

Medalja në pjesën e pasme, ka në mes të saj një gravurë të shekullit XV ku Skënderbeu paraqitet si Dux Epiri Alb, dhe ruhet të Bibliotekën Kombëtare të Parisit. Për përgatitjen e medaljes gravura e Skënderbeut, qoftë për shije astetike dhe kuptim historik, është rrethuar nga stema të ndryshme të Princave Shqiptar si edhe Shtete të huaja, që patën të bëjnë me Skënderbeun në atë periudhë. Ndër to gjendet edhe Stema e Parisit, dhe ajo e qytetit Poitiers, ku Akademia, me rastin e 400 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut 1868 e përkujtoi solemnisht.

Ky përkujtim duhet të ketë pasur lidhje në mes të fitoreve të Skënderbeut kundër Turqve në Lindje të Europës, dhe të Fitores së Karl Martellit kundër invazionit të Francës nga Arabët, në Perëndim të Europës. Në këtë shesh do të vendoset një statujë monumentale me përmasa 5 metra. Për realizimin e kësaj vepe është përgjedhur skulptori shqiptar Agim Rada. Në shtatoren e Skënderbeut nuk do të mungojë edhe kryqi e shqiponja, simbol i stemës së Kastriotëve.

KONKLUZION

Të gjithë shqiptarët kudo që jetojnë kanë për detyrë të zbulojnë personalitetet e mëdha e të shquara me origjinë shqiptare, njerëzit që kanë dhënë kontributin e tyre të çmuar për zhvillimin e njerëzimit, për t'u bërë atyre ndërimet që u takojnë, sepse kështu nderojmë vendin tonë, i cili ka kaq shumë nevojë, sidomos tani në rrjedhën e proceseve integruese, ku ne kemi me çfarë të prezantohemi për nga vlerat dhe identitetin tonë kombëtar.

P

POEZIA

NGA RUDOLF MARKU

VENDI IM

Emri yt ende nuk është shkruar.
Vazhdon ngjijten lënde në drejtimin e kundërt të gravitacionit të dashnise
Në trajektoren e dhëmbshme të harrseses.
E di se këtu kujtesa vret me tepër se Terrori
O Vendi im i braktisur nga gjuha.

Askush nuk na thotë vendin se ku jemi.

E prape vazhdon te ngjitesh në malin mistik të teologjisë së dëshpërimit
Me formula të frikëshme honesh. Derisa arrijmë në atë pikën mes Qiellit dhe Tokës.

Në vendin më të bukur të Dheut. Jo shumë lart, por jo dhe aq poshtë,
Në qoshkun e preferuar të engjëjve.
Vetë Engjëlli i Historisë të ka zënë pritë,
Me plagët e masakruara të Fatit:

Engjëlli i Historisë që nuk na thotë as vendin se ku jemi
O Vendi im !

PER E. B.

Ti më thua se Poezia është një gurë i lemuar
Që e marrim me vete pa u kujtuar kurrë.
Trishimi është ulur në shkallët tona,
Me syte e ftohtë në veshtron me këmbëngulje,
Trishimi që nuk ka ku të shkojë, i përzenë nga të gjithë.

Perpiqemi të jemi njerëzor. Ecim vertikalisht,
Flasim për qyteterimin, për galaksitë dhe librat
Me një sintaksë rrethore;
Dhe koha që përsërit veten!
Sa vite kaluan që kur e thymen buken bashke?
Që kur enderrat i vumë në ca diagrame
Për të arritë labirinthe me hyrje falas?

Në stinen pritëse të marr me vete,
Drejt Beteheimit. Pa një yllë orientues
Vetem me at' gurin e lemuar që për pak e harrojmë.
Nisje nuk ka. Ka vetëm mbërritje.
Ti prek bashkëngjelloret e dhembjes me gishtërinj delikate
Për të shkruar strofen aleksandrine të vetevevrasjes.

Pa e kuptuar kemi arritë Oqeanin Paqësor.
Qenka e lehtë të shohesh se si koha ngrihet
Nga dallgë të stërmëdha për t'u mbytur prapë!

POETËT

Poetët mbledhen në Ferr,
Mes sqafurit djegës. Bisedojnë te qete
A thua se janë në shtëpinë e tyre.

Gjuha është një tunel i pafundmë:
Bashkëngjellore basësh. Zanore prej flauti.
Por zhumat në Ferr i mbysin bisedat e tyre.
Kush tha se do të donin t'i zhvendosnin yjet
Drejt Meshires? Drejt perdelimitit?

Poetët janë qytetare të Ferrit,
I mbushin penat e tyre me sqfuri, me gjakun e vet,
Me enderrat e të panjohureve, me rrefime fantazmash,
Te denuar për shkak të lingujve, të rilmit, të fjalëve
Degjojnë bisedat sekrete të sferave qiellore.

Poetët janë qytetare të Ferrit.
Ecën neper hone malesh, kundër gravitetit të dashurisë
Për të arritë mekataret e braktisur nga gjuha

KURRË NUK DO ARRIJË NË TIRANË

Shkapërcej male, lugina, hone të frikëshme,
I bie mespërmas Mesdheut, Adriatikut, Jonit,
Por nuk arrijë në Tiranë,
Dhe jo e jo në Shqipëri.
Në Heathrow, Gatwick, Stansted me qeshin,

Autori i njohur vjen pas shumë kohësh të "Milosao" me një cikël që e ka përzgjedhur vetë. Kultura e ndih që të përshfaqë në shumë shtresëzime ndjenjën e tij...



Më thonë se nuk do shkosh asgjekund,
As në Aldorado dhe as në Ferr,
E pastaj më thonë me takt, me kujdes,
Eshhtë më mirë të mos marrë as avion e as tren.

Sepse Trishimi nuk qenka gjeografi,
Sepse Trishimi nuk qenka Vend.

Zgjedh rrugë të tjera. Me anije, tragete, nëndetese,
Kaloi tunele sekrete të nëndeshme të mallit,
Përdor taktikat moderne të kalapulteve të kujtesës,
Teknologjinë më të fundit të shpejtësive të zemres;
Në Rinas me qeshin e pastaj më thone
-E kupton dhe vetë se nuk ke mbërritë në Tiranë,
Dhe jo e jo në Shqipëri

Sepse Trishimi nuk na qenka Vend,
Sepse Trishimi nuk na qenka gjeografi.

ARGONAUTËT

Askush nuk i kujton më Argonautët.
Por ne, një grusht njerezish disi të fantaksur
Vazhdojmë të presim në breg kthimin e tyre:
Here pas here një pulebardhë e gjakosur
Na thotë se i ka parë në vorbullat e Bermudës,
Atje ku dallgët janë më të larta se Olympi.

Dhe ne, me kokëfortësi vazhdojmë të presim.
Netteve shohim të njëjtin yje që shohin dhe ata,
Derisa ndjejmë etjen e tyre në buzat tona të thara.
Uria është kudo e njëjtë. Dhe vdekja po ashtu!

E gjithë jeta jonë është pritja e kthimit të tyre,
Një grusht njerezish që bëhemi përherë e më të pakët.
Sa herë që një pritës nga rrradhet tona vdes,
E dime se njëri nga marinarët e Jasonit ka vdekur,
Kufomën e hedhim në thellësitë e detit
Po ashtu siç bëjnë në largësi dhe Argonautët.

E gjithë jeta jonë është pritja e kthimit të tyre!
Tani gjithnjë e më tepër tregojmë për bemat e Argonautëve,
Skicojmë harta vendesh të largëta,
Flasim për ishuj misterioze, për vorbullat e Bermudës,
Lekuren e kemi të rreshtur nga dielli, nga ernat dhe kripa e detit
Dhe jemi fare të pakët.

Dhe femijet e femijëve tanë do ngulin këmbë një ditë
Se Argonautët ishin ne, që kemi pritë!

DITËLINDJE

Veç një dëshirë të lejohet në ditëlindjen lënde,
Pavarësisht sa qirinj ke mbi torte,
Sigurohu mirë para se t'u frysh qirinjëve,
S'na lejohet t'i ruajmë dëshirat për më vonë.
Sa keq që nuk japim kredite dëshirash,
Mos kerko dëshira-shlesë për vitin tjetër,
Do e kuptosh vetë se një është mjaft,
Do e kuptosh vetë se s'ka vend për më tepër!

Ji realist! Dëshirat vijin nga tre veç në përralla,
Por dhe kur vijin, kerkojnë shpërblime mizore,
Pastaj njerëzit nuk dinë as se çfarë duan,
Pasatj njerëzit nuk dinë as çfarë kerkojnë!
Përgatitu për zhgënjimin, ose me mirë
Fillo të kursesh me kujdes për më vonë,

Që të jesh gati për një zjarr të papritur
Dhe me qindarkat të paguash shpresat që s'vijne.

Veç, një dëshirë na lejohet në ditëlindjen tonë!

EVA

Kur trupi im është me trupin tënd të çveshur,
Në dilet e Veres, më këngët monotone të gjinkallave,
Shoh pjesen tënde të bardhë tek ngjitet në qiej,
Sipër kambanareve, sipër deveve dhe maleve,

Në ca Parajsa që as emërin nuk ua dijmë.

Por gjysma tjetër e errët mbelet me mua, këtu poshtë,
Me gurët, me pluhurin dhe rrenjëjt e bimëve a të pemëve,
Me terheq me forcë tek hijet e pasdrekës së vonë,
Në thellësitat e parajsave të verteta a të rreme,

Me rënkime që aq mirë kuptimin ua dijmë.

Strasbourg, France 2018

KËPUCTARI PLAK

Këpuçet e vjetra nuk i ndreqin më:
Vonë në muzg i hedhim në qoshen ku nuk na sheh askush,
Sikur të ndjenim turp prej tyre. E kush nuk ndjen turp nga gjërat e vjetra?
Po këpuçtari plak ku mund të jetë? Ai që kerrusej
Për të arnuar shollin e ngrënë, lekuren tërë plasa, thumbat si dhembë të rënë?
Më thonë se ka vdekur,
Dhe unë nuk mund t'ia sjellë as emërin ndërmend.

Këpuçet e vjetra nuk i ndreqim më,
Këpuçet që na çuan në takimin e parë, e më pas në varrezat e të dashurve tanë.,
Në rrugët e largëta të trajektoreve së delirë;
Ka kohë që dhe letrat e dashurisë i grisim në fshehtësi,
Ka kohë që dhe emërat e të dashurveve i fshehim mirë e mirë.

Ka kohë që as Dashuritë e vjetra nuk i ndreqim më,
Dhe as puthjet e dikurshme të dale mode,
Dhe as atë pagjumësinë e dashurisë nuk e riparim më,
Dhe as rrahjen e ankthshme të zemres që rënkonte.

Jelojmë në kohën kur nuk i riparim gjëra që dëshëm dikur,
Jelojmë në kohën kur gjëra e vjetra i flakim në rrugë
Për t'u ndjere me mirë e me të të sigurte.

ALKIMISTËT E DASHURISË

Poetët nuk janë zotj migratorë, nuk shteglojnë në vende të largëta,
Madje dhe kur vdekja i merr pa lajmëruar askënd
Na përhendësin nga afer, na thone se nuk jemi larg.
Miku im vazhdon të dërgoj poezitë e tij që nga bola tjetër,
Poezitë e fundit që nuk kishim kohë t'i lexonim bashkë;
Poezitë e fundit që nuk m'i dërgon me postë ngaqë kurrë nuk u besoi postave:
Poezi për zhgënjimin dhe dashurinë, elegji për rënimet e shpirtit,
Për lotët që duhej të kishim derdhur në vajllimin e madh të Njeriut,
Por as dhe një varg të vetëm për Vdekjen,
Ai që jetonte çdo çast me Vdekjen.
I lexojmë kur jemi të vetmuar, kur ai vetë na mungon,
Dmth çdo ditë a çdo mbrëmje vonë.
Poeti tjetër, ai që zbulon metrikat sekrete të kthimit të gjërave në Dashuri,
Shkruan In Love për Anën që e thërrret në ditë të gjumë,
Për dashurinë që është çdo gjë,
Që është kudo dhe kurdo- veç të kesh shpirt që ta shohësh,
Veç të kesh shpirt ta prekësh a të jetosh me të.
Ai vetë na lexon ne që nga faqet e librit të vet,
Teksa ne lexojmë vargjet e tij delikate si porcelanët e Japonisë,
Teksa ne lexojmë vargjet e tij të verteta si retë apo endërrat alkimike të dashurisë,
Na lexon dashuritë tona, trishimin, banalitetin a shtirjen tonë të pafat.
Poetët nuk janë zotj shleglarë, nuk migrojnë në vende të largëta,
Janë rreth nesh, në kafene a në bregun e detit,
A në këshjellat mesjetare duke lexuar me mjetet e elektronikës Trobadurët.
I shoh në shoqëri me Budin a Bogdanin, i shoh në kafene me Rilken a Whitman-in,
Me Poesan enigmatic a me vetë Shekspirin;
Herë të tjera i shoh tek qëndrojnë në radhë për të paguar faturat
A për të tërhequr pensionin e herë të tjera tek kthehen nga yjet e largët,
Por gjithomone afer. Kush tha se Poetët janë zotj migratorë? Se atyre u pelqen të shteglojnë!
I kemi afer, shumë afer shtëpisë. Takohemi çdo ditë në Londer, Paris, në Alpet e Bavarisë,
Në Buenos Aires, në Antarktikë, në Lezhë e Liezh, në Amsterdam a në Aachen,
Në Maastricht a në Romë, në Malin e Veles a në Konstelacionin e Andromedes.
Kush tha se Poetëve u pelqen të shteglojnë? Se ata endërronin veç largësi?

Poetët që vete Galaksinë e shndrojnë në shtëpinë më të zakonshme,
Ndersa shtëpitë e veta i kthejnë në Galaksi!

Londer, 2018

T

TREGIM



Foto nga Miroslav Çurçiq

NGA Miroslav Çurçiq

Në dorë kam një qese me dy kokrra qepë të njoma dhe një copë pastërma me aromë të këndshme. Nën shtetull mbaj një bukë të nxehtë dhe gazeta të djeshme. Ashensori i vjetër më çon ngadalë në katin e dëshiruar. Nuk bëj zhurmë derisa eci nëpër korridorin e gjatë. Po kthehem në shtëpi nga turni i natës dhe bëj kujdes ndaj atyre që flenë ende. Puna e rojeve të natës, që punojnë nëpër qendra tregtare të mëdha, nuk është aspak e lehtë; ecejaket, vetmia dhe frika nga zërat e çuditshëm. Ka shumë kohë që ditën e kam ndërruar me natë. Zbehtësia e fytyrës sime e tregon këtë.

Pastërmaja është mbi dërrasën prej ahur; e prerë. I hedh kripë pja-tancës së bardhë prej porcelani. Bukën e copëtoj në dy pjesë. Ambienti mbushet me erëra. Pikëzët e ujit dergjen nga qepa e sapolarë mbi mushamanë laramane, me të cilën është mbuluar tryeza. Marr

NGA Miroslav Çurçiq

Secili ushqen pasionin e vet, sh kruan me spray të kuq mbi një fasadë të vjetër. Shkronjat janë të mëdha dhe të lakuruara. Grafiti është bërë gjatë natës. Gjithmonë merr të njëjtën rrugë dhe është e sigurt se dhe nuk ishte aty. Pyet vetveten pse njerëzit lënë mesazhe në këtë mënyrë? Mendon për kuptimin e kësaj fjalie.

Në punë arriti një orë para hapjes së qendrës tregtare. Shkallët e lëvizshme e sollën te kati i fundit, ku janë restorantet ekspres. Te hyrja, në një sallë të madhe, ndjen aromën e dyshemesë së porsapastuar. Karriget janë të radhitura rreth tryezave bosh dhe të pastra. Punonjësit janë pas banakëve. Është e vetëdijshme që trupi i saj tërheq shikimet e meshkujve. Kujton se kjo do të mund të jetë një nga pasionet e saj; dëshira e fortë për kontrollin mbi çdo situatë. Ndjen gurgullimat e lehta të zorrëve. Ecën vendosmërisht te djali i buzëqeshur, që i ofron një tabak plastike.

Mish pule nga Kentucky (KFC), vakti Grader Texas, përfaqëson një mënyrë të përsosur për ta filluar ditën. E hap pa shumë durim letrën laramane. Aromat që çlirohen sakaq e rrëmbejnë kurdohere me vete. E vërtit sanduicun e rrumbullakët midis gishtërinjve, duke zgjedhur se ku duhet ta kafshojë; rrrahët e qepës ngjyrëviolet dhe copat e fërguara të mishit dalin nga

Autori që çeli vitin letrar "POETIKA Tirana in Between-2018" është tregimtari nga Beogradi Miroslav Çurçiq. Ai lindi në vitin 1966. Tregimet e tij janë botuar në një revistë letrare dhe në antologji të tregimit të shkurtër në rajonin tonë si dhe janë përkthyer në anglisht dhe rumanisht. Miroslav Çurçiq është pjesëmarrës aktiv i turneut të madh të autorëve të tregimeve të shkurtra në kuadrin e KIKINDA SHORT FESTIVAL. Ai ka botuar përmbledhjen me tregime "Vdekja në Bashaid", i cili është pritur me vlerësime nga kritika. Tregime nga ky libër, nën përkthimin e Merima Kriezi, janë botuar edhe më herët në gjuhën shqipe në revistën "Poetika" dhe në suplementin letrar "Milosao", ku mes të tjerëve veçohen "Hipnoza" dhe "Si mbeta pa gishtin e madh...". Gjatë qëndrimit të tij në rezidencën letrare, Miroslav Çurçiq u përfshi në jetën kulturore të kryeqytetit shqiptar, vizitoi galeri arti, Muzeun Historik kombëtar, BUNKART, bëri udhëtime në qytete të Shqipërisë, mes të tjerëve në Durrës, krijoi lidhje me përkthyes dhe njerëz të kultures, mbajti një ditar udhëtimi dhe zhvilloi hobin e tij mbi fotografimin e qendrave dhe të periferive.

Luna

nga frigoriferi një kanaçe birrë dhe tekta eci e hap. Dëgjohej një tingull karakteristik, shpërthyes. Shkuma del me vrull nga vrima trekëndëshe dhe derdhet mbi parket. Hidhem mbi pellgacën e shkumës së birrës. Do ta fshij më vonë. Trupin e rraskapitur e ul në karrigen komode dhe këmbët i ngre në taburen prej lëkurë. E vështroj Lunën si fle. Ia afroje drej gojës kafshatën e parë.

Luna rri shtrirë mbi kurriz. E ka lakuar këmbën e djathtë. Çarçafi i mëndafshit është i rrudhur dhe i hedhur poshtë nga



Shkrimtari Miroslav Çurçiq

shtrati. Ajo i ka sytë të mbyllur, kurse mua më shkon ndërmend se ndoshta nuk është në gjumë. Nuk do të habitësia po të shtiret sikur është në gjumë. Duart, me gishtërjinj të ndarë, i ka në mes të këmbëve. Thimthi i majtë i është mbledhur pak dhe ka marrë formë mjedre. Thimthin e djathtë e ka të mbuluar. Buzët i ka pak të hapura. Labiat nuk i shoh, por paramendoj se edhe ato gjithashtu janë pak të hapura.

Ndiej uri tekta e vështroj. E zhys qepën në kripë dhe e kafshoj. Një çurg i hollë shpërkat nga e bardha e tultë. Ajo e mbuloi me duar burimin e saj. Gishtat i ka të gjatë. Sa do të doja të më ushqejë me këta gishta. Përfytyroj si m'i afron kafshatën e unë hungërisë dhe skërmët dhëmbët. Ajo kinse bërtet, duke u frikësuar se mos e kafshoj. Këtë e di nga filmat.

Kafshoj pjesën e tultë të bukës

dhe shikoj në pjesën shtesë e të fryrë të saj. Ngjesh brumin e nxehët. E mbështjell me një fetë pastërma shumëngjyrëshe të prerë hollë. E fus të gjithën në gojë dhe ia shtoj një birrë. Lumturinë e bëjnë gjëra të vogla; një kafshatë e përsosur dhe thimthi më i bukur në këtë botë.

E marr gazetën nga tryeza. Në ballinën e saj janë njerëz që unë nuk i njoh. Në këndin e djathtë, lart, qëndron data e sotme. I palos faqet e gazetës dhe, hedh edhe një herë shikimin te vajza me këmbë të hapura. I ul këmbët në dysheme



Foto nga Miroslav Çurçiq

ngrihet dhe ngadalë nisem në zyrë. Dega bankare në të cilën ajo punon si referente kryesore gjendet një kat më poshtë. Vala e parë e blerësve pritët për dhjetë minuta. Atëherë fillon orari i punës së saj.

Nëpunësi i sigurisë së bankës i hap derën. Ajo i buzëqesh. Me shikim dhe me shenjë pohuese të kokës komunikon me nëpunësit e tjerë. Të gjithë janë në vendin e punës. Hyn në tualet dhe e var cantën mbi dorezën prej nikeli të shkëlqyer të derës. E rrotullon çelësin dy puna e saj, çdo gjë është lidhur me shifrat. Pi një gjëllënkë kafe dhe e ujit kafshatën krenn nga pjata e bardhë. I kontrollon mesazhet në celular;



Shkrimtari Miroslav Çurçiq

URIA

i drejtojnë klientët e tyre te dega bankare ku punon ajo. Kreditë e shpejt cash konsumatore janë shumë të popullarizuara te njerëzit pak të qëndrueshëm në blerje.

Shefat e dyqaneve gjithashtu janë konsumatorët e shërbimeve për kredi, por me kushte të ndryshme, më të volitshme. Kontratat e tyre ajo i mban në një dosje të posaçme. Është e çuditshme që klientëve as nuk i shkon nëpër mend se çfarë lloj përfundimesh mund të dalin nga shifrat në ato letra. Kur fjala vjen te puna e saj, çdo gjë është lidhur me shifrat. Pi një gjëllënkë kafe dhe e ujit kafshatën krenn nga pjata e bardhë. I kontrollon mesazhet në celular;

dhe, shkoj i mërzhitur në banjë për të marrë leckë me të cilën do ta fshij birrën që u derdh. Teksa pastroj dyshemenë, mendoj se si fluturon koha. Shpejtësia e të kaluarit të saj më vë në siklet. Muajj mars kaloi sa hap e mbyll sytë.

Qëndroj mu afër murit në të cilin varet kalendari me fotografi. E shqyej posterin e marsit dhe para syve më del një bukuroshe që do të më presë gjatë tërë muajit prill. Quhet Mia; sa emër i bukur. Do të më nevojiten së paku tri ditë të mësohem me të. Është biondinë. Gjynjtë i ka dyfish më të mëdhenj se Luna. Po i lan dikujt makinën e kuqe sportive. Gjithkrah rreth saj është me shkumë. Mbi fytyrën e saj dallohen lumturia dhe emocionet. Cicat i ka të shtrira mbi xhamin e përparmë të makinës të lagur. Janë të shtypura mbi peshën e saj. Duken si palaçinka. Fotografimi me siguri i shkrepit foto nga ulësja e shoferit. Sa do të doja të merresha me punën e tij. Kjo është punë që paguhet mirë, gjithashtu besoj se nuk të lodh fare.

kalon nëpër grykë e jo nëpër hundë. Efektet e padëshirueshme, që bën acidi i stomakut, janë më të buta. Ka hapur gojën. Turrjet e stomakut janë më të forta, por shtrëngimet e gishtërinjve të saj më të fuqishme. Mish pule i patretur nga Kentucky kërcen turpshëm nga të brendshmet e saj drejt ujit të kthjellët të ujësllësit të qytetit. Rënkon, tekta po vjell. Mjekrën e ka të ngritur lart. Kjo nuk mësohet në fakultet, mendoi. Copëzat e fundit të mishit të pulës i kalojnë mbi dhëmbë. Fije pështyme janë shtrirë deri te tualetit prej qeramike. E copton dhe e shkund me gishtin tregues. Dëgjohej gurgullima e shqetësuar e zorrëve. Ajo lëshon ujën që merr me vete të gjitha provat e mëngjesit të sotëm. Lahet me pecetë letre, fshin fytyrën dhe shpërlan gojën. Sytë i ka të përplotur dhe të skuqur për shkak të mundimit. Zgërdhiet duke shtyrë nofullën përpara. Shtrëngon me gishtin tregues lëkurën rreth syve, duke fshirë përkohësisht rrudhat e para që iu paraqitën. Nxjerr nga çanta çamçakëzë me aromë mente, rregullon flokët shpejt e shpejt dhe i jep shkurtimisht një buzëqeshje pamjes së saj në pasqyrë. Merr frymë thellë dhe del jashtë.

Me stomakun e zbrazët dhe me ndjenjat e mprehura kalon pranë klientit të parë, që pret me durim të fillojë dita e saj e punës.

Përkthita nga serbishtja Merima Kriezi

A

ANTROPOLOGJIA



PROF. ALBERT DOJA*

Vijon nga numri 1 i shkruar

Kërkesa e një kushti operativ që në studimin e miteve shprehet si një kusht kufizues në kuptim matematikor mund të jetë me interes të veçantë për studimin e transformimeve identitare, në analizën krahasuese të transformimeve që rezultojnë nga dinamika ndërkulturore, veçanërisht në proceset e ndërtimit identitar dhe të politikës identitare. Kjo më sjell në rastin e fundit, domethënë propozimin kërkimor mbi morfodinamikën e transformimeve identitare evropiane që kam ndërmend të zhvilloj gjatë qëndrimit tim në Harvard si studiues vizitues dhe që synon të fuqizojë konstruktivizmin neo-struktural duke kthyer vëmendjen drejt implikimeve thellësisht politike.

Marrëdhëniet shoqërore janë shpesh të çuditshme dhe kundërtë. Veçanërisht në fushën e identitetit, praktikatat ligjërimore nuk kanë gjithmonë veçori të përcaktuara ontologjike. Shpesh ato duket sikur janë të ngatërruara në kombinime të çuditshme gjendesh në dukje të papërpunueshme të karakteristikave të tyre shoqërore, që mund të jenë etnike-fetare dhe kombëtare-populiste apo qytetare dhe normative. Në këtë kuptim, ontologjia e identitetit mund të krahasohen me gjendjen në dukje misterioze të grimcave që në mekanikën kuantike quhet mbivendosje. Grupe fizikanësh nga Massachusetts Institute of Technology dhe disa universitete franceze po kryejnë prova në kushte reale për të parë nëse grimcat kuantike ekzistojnë vërtet në gjendje të mbivendosjes. Me duket se një lidhje e krahasueshme kuantike për t'u provuar mund të ekzistojë edhe në fushën identitare midis ideve, vlerave dhe motiveve në dukje të kundërta dhe të papërpunueshme. Supozimi kryesor është se transformimet identitare preken nga ideologji kulturore në dukje të kundërta, por që janë në marrëdhënie të ndërsjellë ndaj njëra-tjetrës duke vepruar si instrumente politike të pushtetit dhe hegemonisë.

Në nivel empirik, supozoj se integrimi evropian nuk është kurrë i plotë dhe marrëdhënie të paqëndrueshme ekzistojnë mes ideve qytetare dhe motiveve shoqërore. Ndërsa proceset logjike dhe tensionet politike duhet të hulumtohen në lidhje me ndryshimet identitare në nivelet shoqërore, etnike, fetare, rajonale, kombëtare dhe mbikombëtare. Por në shumë situata, praktikatat ligjërimore nuk janë domosdoshmërisht të pozicionuara mbi një domethënë të veçantë identitare, pasi vëzhguesi në studimet shoqërore, si dhe në mekanikën kuantike, ndikon mbi atë që vzh-

Për një gabim teknik e kemi ndërprerë artikullin gati në fund. Për ta bërë më të kuptueshëm, po e botojmë të gjithë sythin e fundit, duke e kërkuar ndjesë autorit. Shpresoj ta zhvilloj këtë projekt në bashkëpunim edhe me kolegë të interesuar nga Harvardi, që mund të bashkohen me bashkëpunëtorët e tjerë nga Evropa, antropologë, sociologë, gjeografë, politistë, specialistë të shkencave të komunikimit, informaticienë dhe matematikanë nga Franca, Belgjika, Italia, Austria, Polonia dhe Bullgaria. Një dizajn infrastrukturor i rëndësishëm është i nevojshëm për modelimin e protokolleve kompjuterike bazuar në ekstrapolimet bayesiane, formalizimin DEVS dhe përpilimin e referencave numerike sistematike të praktikave ligjërimore identitare- shprehet ai.

POLITIKA IDENTITARE

gohet. Kjo bëhet e qartë vetëm kur kërkojmë domethënien e tyre. Identitetet e papajteshme mund të jenë thellësisht të lidhura, pasi veçoritë e tyre përputhen në kundërshtim me njëra-tjetrën vetëm kur ato vërehen dhe përcaktohen si të tilla. Këtu është e rëndësishme që dalimi midis termave indeksale dhe vlerave funksionale të fushës identitare të konceptohet në mënyrë topologjike si relacionale dhe jo substanciale. Kjo do të thotë se pozicionet relative të indekseve, llojeve, agjentëve, njësive dhe ontologjive identitare përcaktohen nga një

rrezik të dukshëm të aktivizimit ligjërimitor të politikës instrumentale dhe agjencisë ideologjike që qëndrojnë të fshehura por që mund të nxisin etnicizimin e vlerave evropiane dhe rezultate të pamenduar të politikave publike. Modeli neo-struktural i fushës identitare pritet të kapë këtë proces, duke u bazuar në rregullat evolutive të transformimeve kanonike të përcaktuara nga Lévi-Strauss dhe në konceptin e fushës politike të huazuar nga Pierre Bourdieu. Në teorinë e fushës së Bourdieut, marrëdhëniet e pushtetit rikuadrohen

që mund të shpjegojë politikën identitare si një sistem identitetesh varësisht nga historia e transformimeve të tyre. Riformulime të mëtejshme logjiko-matematikore të metodologjisë së Lévi-Strauss mund të ofrojnë formalizimin logjik të rregullave transformuese në situata konkrete të fushës identitare, që mund të lejojnë rrokjen e një "mekanizmi gjenetues" të identiteteve bazuar në transformimet e tyre. Kjo do të thotë, për shembull, se sequenca e dyfishtë e bujarisë ndaj vendësve dhe keqbërjes ndaj të huajve plotësohet nga një tjetër sequencë e dyfishtë e keqbërjes së vendësve sikur u bëhet një lloj bujarie të huajve që tashmë janë injoruar apo nuk ekzistojnë dhe që nuk mund të jetë veçse një bujarie e përmbytur me kokë poshtë ose anti-bujari **[F(b)V : F(k)H :: F(k)V : F(H)b]**. Kjo mund të duket e çuditshme, por ndodh më shpesh nga sa duket, veçanërisht në lidhje me praktikatat publike të shtrembëruara nga argumentet populiste.

vendas^(bujari) : huaj^(keqbërje) :: vendas^(keqbërje) : bujar^(huaj)

Kartografi i ndërveprimit të termave dhe funksioneve identitare mbi marrëdhëniet permutacionale midis indekseve, funksioneve, llojeve, agjentëve, njësive, ontologjive dhe ideologjive identitare synon të pasqyrojë pozicionet e tyre në fushën identitare, ndërsa riformulimi i marrëdhënieve të tyre topologjike në mënyrë kanonike duhet të tregojë se si transformimet identitare mund të rroken në mënyrë që të zbulohet agjencia instrumentale prapa politikës identitare. Kështu për shembull, simulimet kompjuterike të funksionit normativ **[F(n)]** të identitetit qytetar **(Q)** do të ballafaqohen me funksionin shoqëror, etnik e fetar apo nacionalist, populist e fundamentalist **[F(e)]** të identiteteve kulturore **(K)**. Idealisht, ky ballafaqim supozohet se sjell transformimin e identitetit kulturor në një identitet me funksion normativ **[F(n)K]**. Megjithatë, formulimi kanonik i kësaj marrëdhënie **[F(n)Q : F(e)K :: F(n)K : F(Q)e]** tregon gjithashtu nëse funksionin normativ i identitetit qytetar **[F(C)]** mund të jetë transformuar në agjenci ambivalente, ndërkohë që fraksionet politike apo grupet shoqërore mund të karakterizohen nga një identitet evropian i fshehur e i pamenduar **(e)**, por që qëndron si një lloj "etniciteti" i Europës së përmbytur me kokë poshtë ose anti-Europës.

qytetari^(normativ) : etnike^(fetare) :: kulturë^(normative) : etnike^(qytetari)

Le të kujtojmë se në studimin struktural të miteve nevojitet një kusht operativ shtesë në formën e një kushti kufizues në kuptim si empirik dhe matematikor: Në fushën identitare, kjo kërkesë validimi duhet të na çojë në kërkimin e agjencive të fshehta instrumentale të politikës dhe ideologjisë identitare që mund të shtërrojnë transformim-



grup i strukturuar i marrëdhënieve të pushtetit dhe identiteteve të grupit që arrijnë transformimet e tyre përmes politikës identitare. Në të vërtetë, cilado nga veçoritë e veta, çdo identitet është i zbatueshëm vetëm në lidhje me një tjetër identitet dhe mund të realizohet vetëm në kufirin e njërit në kontakt, në konfrontim, apo në kontrast me tjetrin. Në këtë kuptim, idetë qytetare dhe motivimet etnike duket se ekzistojnë në një gjendje mbivendosjeje kuantike dhe kanë kuptime të shumëfishta konfliktuale në të njëjtën kohë. Nëse janë të ngatërruara në këtë mënyrë, ashtu si ndodh me grimcat në mekanikën kuantike, mund të parashikojmë që kur zbulohet pozita kulturore e motiveve etnike, identitetet qytetare dhe etnike bien në pozicione saktësisht të kundërta të ideologjive instrumentale. Këtu supozoj që fusha identitare është përsëri e krahasueshme me parimin e papërcaktueshmërisë së Heisenberg në mekanikën kuantike, duke pasur parasysh se sa më saktësisht të përcaktohet pozicioni kulturor i vlerave dhe qëllimeve identitare, aq më pak mund të njihet momentumi identitar i rezultatit të masave që duhen marrë në rrafsh politik. Në fakt, dualiteti grimca/valë në fizikën kuantike mund të mendohet si të ishte një ndërveprim i shumëfishtë në fushën identitare midis ideve qytetare dhe motiveve etnike.

Në nivel konceptual, supozoj se kjo papërcaktueshmëri zbulon një



si linja forcash në një fushë elektromagnetike, ndërsa hapësira shoqërore rikonceptohet si një shumëllojshmëri fushash relativisht autonome. Në fushën identitare evropiane, dinamika e bashkëveprimeve tregon se praktikatat ligjërimore mbështesin ose mohojnë modalitetet të përkatësisë që përputhen me logjikën publike dhe përdoren instrumentalisht për të ndikuar formimin dhe transformimin identitar.

Ndonëse tensionet e mundshme politike në riprodhimin e fushës identitare pengojnë ose inkurajojnë kapërcimin e kufirit, mund të mendohet se çdo kapërcim gjenetor një efekt histerezë, që është matematikisht i llogaritshëm në fushat elektromagnetike dhe fusha të tjera dhe

in identitar në njërin apo tjetrin drejtim. Tek e fundit, referencat narrative të termave indeksale dhe vlerave funksionale në kategoritë e koduara të praktikave ligjërimore identitare dhe modelimi i vlerësimit të nënkuptimeve të tyre duhet të japin indikacione të sakta për realitetet e fshehura që karakterizojnë situata empirike të etnicitetit të marrëdhënieve socio-kulturore ose të evropianizimit të vlerave shoqërore, etnike-fetare apo rajonale-kombëtare. Qëllimi është të përftohet një model kompjuterik për të konceptuar dhe hartuar në mënyrë rekursive përcaktuesit e solidaritetit qytetar dhe qëndrimeve ndërkulturore, që të mundësojë zhvillimin e një instrumenti politikbërës për të vlerësuar mënyrat se si vlerat themelore dhe transformimet identitare evoluojnë si kushte kufizuese të integritetit evropian, kohezionit social dhe dinamikës ndërkulturore.

Në nivel metodologjik, kjo mbetet ende pjesa më e pazhvilluar këtij projekti kërkimor pavarësisht bashkëpunimit të ngushtë me kolegët nga Qendra e Inxhinierisë Informatike të mjedisit, shoqërisë dhe identitetit në Universitetin e Korskisë. Shpresoj ta zhvilloj këtë projekt në bashkëpunim edhe me kolegë të interesuar nga Harvardi që mund të bashkohen me bashkëpunëtorët e tjerë nga Evropa, antropologë, sociologë, gjeografë, politistë, specialistë të shkencave të komunikimit, informaticienë dhe matematikanë nga Franca, Belgjika, Italia, Austria, Polonia dhe Bullgaria. Një dizajn infrastrukturor i rëndësishëm është i nevojshëm për modelimin e protokolleve kompjuterike bazuar në ekstrapolimet bayesiane, formalizimin DEVS dhe përpilimin e referencave numerike sistematike të praktikave ligjërimore identitare.

Shkëmbimi i vendeve dhe roleve diferenciale midis termave indeksale dhe vlerave funksionale në fushën identitare është një logjikë diktomizimi permutacional që ndërtohet në seri metaforike dhe metonimike. Seri të hapura cifesh antitetike të indekseve, llojeve, agjentëve, njësive dhe ontologjive identitare, si dhe permutacioni i vlerave të tyre indeksale dhe funksionale, janë në dispozicion të çdo agjenti në të gjithë fushën identitare për t'u fiksuar në mënyrë të dukshme mbi llojet identitare të njësive të ndryshme referuese, qofshin individë, grupe shoqërore, shtete kombëtare, institucione, organizata. Praktikisht, roli i aspekteve metaforike dhe diktomike të praktikave ligjërimore, si dhe marrëdhënieve funksionale që ato sugjerojnë për kategorizimin identitar, do të hulumtohen në lidhje me zhvendosjet funksionale në varësi të faktit nëse të njëjtat metafora përdoren si terma indeksale të shprehjes identitare apo si funksione instrumentale të politikës identitare.

(Fund)
*Anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Profesor titullar Universitetit i Lille's, France. Profesor vizitues, Universiteti Harvard. Fjalëdhënësi i Universitetit Harvard, 20 shtator 2017.
Përktheu nga anglishtja Enika Abezi.
Marrë nga "Social Morphodynamics: Mapping Identity Transformations, Cultural Encounters, and the Evolution of Core Values." Social Epistemology Review and Reply Collective, vol. 7, no. 1 (2018), pp. 14-25. <https://ep.me/1B6f03Sz>.

P
POEZIA

DR. ZEJNEPE ALILI REXHEPI*

Dimensioni tematik i vargjeve të Bislim Ahmetaj, me shtjellimin midis një koncepti filozofik mendimesh dhe originalitetit të përkapjeve jetësore e përbëjnë tërë vëllimin poetik “Edhe zogjtë i mashtrojmë”. Trajektorja e përshkrimit të tyre është si një nisimë pa mbarim dhe një fund pa fillim, midis së cilës mbizotëron revolta. Mesazhi jetësor brenda këtij trazimi mbetet sërish i qëndrueshëm në kohë.

Ahmetaj shkruan me masë, edhe kur shpesh ndodhet para dilemash jetësore, dhe një simbolizim shprehës, ndonëse ka herë atë e mbërthen dëshira për rebelim e nxitur nga revolta dhe ironia. Me këtë, poeti e bashkëdhuron ndjenjën vetjake me preokupimin ndaj kaosit shoqëror, duke e shtyrë filozofinë deri te mosbesimi, me synimin për të gjetur të vërtetën, si përpjekje për t’i sfiduar situatat. Ritmin e jetës e transmeton me të gjitha ulje-ngritjet e individit që brend në kërkim të jetës më të mirë, në rigjetjen e shprehës së humbur, për të arritur ndryshimin e pritsëm gjithëshoqëror. Kontrastet e theksuara shoqërore, vëzhguar në prizmin e realitetit social, ekonomik, politik... e shtynë poetin që të gërmojë midis copash të fashitura të vendit të tij, për ta pikuruar të vërtetën me të gjitha ngjyrimet emocionale që ia ka imponuar koha.

Vëllimi “Edhe zogjtë i mashtrojmë” në realitet, të duket si rrugëtim drejt furtunash, ku individi i pabindur me fatin “e imponuar” lundron i pasigurt në lumin e dhembjes, padrejtësive, papunësisë e mjerimit social, mirëpo asnjëherë nuk duhet humbur kuptimin e jetës. Ndonëse tejet kritik, poeti shkruan me gjuhë zemre, sepse horizont frymëzimi e ka Atdehuni si kult i tokës dhe brenda tij e portretizon shqiptarin e kohës, megjithëse nganjëherë jeta e vetë shqiptarit ka vlerën e hicit, duke përkrahur rrathe golgotë.

Vëllimi nis me poezinë “Fëmijëve jetimë”, në të cilën “njeriu” ndeshet sy më sy me jetën, edhe pse jeta nuk e ka për këdo vlerën e zakonshme, për të cilën gjakon individi, i mbetur vetëm përballë sfidave. Rrjedha e jetës metaforizohet me ca dozë optimizmi, ani pse për të, janë kohë të vështira “...Në mëngjes herët/ Dal rrugëve të qytetit/ E mbledh dromca buzëqeshjes.../...Të mbetura pa u “pastruar” nga fshesarët e përgjurmur”. Kjo ndjesi pasqyrohet me faktin e hënës dritëpakët që i bie në qafë errësirës.

Shumica e poezive të Ahmetaj janë përshkrim situatash e përsiatësh të realitetit, janë përplasje e guximshme me ato dukuri të dëmshme që duhen tejflakur sa më larg. Fundja, poezitë janë linja jete nëpër të cilat domosdoshmërisht kalon

Vëllimi poetik “Edhe zogjtë i mashtrojmë” i Bislim Ahmetaj vjen me penën e një studiuese shqiptare të Maqedonisë. Në këtë vëllim, Ahmetaj, sikur në çdo hap vëzhgon dhe mbledh vëmendshëm ato grimca ndjesish që e arnojnë forcën e jetës për një të nesërme të domosdoshme, por gjithsesi ndryshe. Vargu i tij nuk është kaq i thjeshtë, as për kah kthjelltësia e mendimit, as për kah vlerat gjuhësore.

Filozofia e revoltës në vargjet e një poeti

individi dhe kolektiviteti, edhe kur pas vetes lënë silueta ëndrrash të përgjakura. Ironia e fatit s’ka të sosur edhe atëherë kur njerëzit “...Janë thjesht gjysma të prera fotosh/ Që shërbejnë edhe si pasaporta edhe si bileta/ Fati i tyre shndërronhet në tituj gazetash/ Copa letrash që bredhin trotuareve të pista...” (“Kalorësit e zinj të vdekjes”).

Është mbresëlënëse poezia “Për udhëheqësit tanë”, e cila të nxit pamje të skicuara nga jeta shqiptare, një aktualitet i hidhur që tipizon ambiente autoktone... Përshkruhen portrete udhëheqësish, si në një pikurë plot efekte ngjyrash të përziera pa kurrfarë harmonie, sikurse kur të kaplon ndonjë “trishtim kozmik” dhe pa ndonjë shprehës për më tej, deklaror: “Më ka humbë busulla”. Aftësia perceptuese e poetit që kaq



hollësisht ta përditësojë jetën, bën të mundur që asnjë grimcë përjetimi të mos fshihet gjatë nga kujtesa. Edhe banalizimi i përditshmërisë me “shije” festash të (pa)zakonshme përshkruhet si “ode” për gruan shqiptare. Dhe kjo nuk ka si të tipizohet më qartazi në “Ditë gruaje në Tiranë”, një poezi që reflekton “shpresa” të varura nga efekte ngjyrash, shumësia e të cilave të ngjall neveri deri në absurditet.

Në këtë vëllim, Ahmetaj, sikur në çdo hap vëzhgon dhe mbledh vëmendshëm ato grimca ndjesish që e arnojnë forcën e jetës për një të nesërme të domosdoshme, por gjithsesi ndryshe. Vargu i tij nuk është kaq i thjeshtë, as për kah kthjelltësia e mendimit, as për kah vlerat gjuhësore. Përgjithësisht, janë poezi që kërkojnë lexim të vëmendshëm,

për një zbrërthim dhe interpretim të duhur. S’do mend se pakufishmëria e gjuhës që e elaboron mendimin e kthjellët, e i rrah fort fenomenet politiko - sociale, nuk e prish bashkëjetesën e kësaj gjuhe, herë të ashpër e thumbuese, herë të ëmbël e të këndshme, pothuajse lyster në lyster këngën e zogut, sikurse në poezitë: “Arratia e këngës së zogjve”, “Tinguj harrese”, “Kanga e mbrame e plakut”... “Bilbili, lyp-sari dhe qyteti i ngratë”...

“Edhe zogjtë i mashtrojmë” është pasqyrim në vargje i atyre tablove jetësore, me të cilat ngjeshëm shihemi sy më sy. Janë ata histori të dëguara nëpër shekuj, që po i gërpyem pakës, do shpërbejnë ama gjaku, si dëshmi dhembjesh të pa stisura. Janë e sotnja rënduese që na lodh deri në ngulfatje dhe fatkeqësisht mund të bartet në të nesërmen e pafajshme. Dhe ne, nuk mund të bëjmë asgjë, me bindjen se “të vegjlit” janë të destinuar për “durim” ose “humbje”. Janë po ajo e nesërmeja, ku shpresat metaforikisht, janë ndrydhjet emocionale nëpër kohë. Për këtë të fundit duhet një mal durim, që bashkë me lexuesin të ecet shtigjive të gjata sa pafundësia e jetës!

* Profesore e Letërsisë së Krahësuar në Universitetin Shqiptar të Tetovës

K
KULTUROLOGJI

NGA BEN ANDONI

Komuniteti artistik i vendit kishte shumë shprehës se mbyllja e mandatit të qeverisë Berisha do të sillte ndryshimin e pritur. Para pesë vitësh, qeverisja e lodhshme dhe shumë populiste e tij i kishte bërë qytetarët shqiptarë të mendonin se kushdo që do të vinte më pas, sido që të ishte, do të punonte më mirë. Në këtë terren erdhën Socialistët dhe për hir të së vërtetës u munduan ta fusin disi në hulli mes të tjerave edhe kulturën shqiptare, një strukturë të madhe dhe shumë konglomerate, që i mungojnë pa fund fondet. Ndryshe nga paraardhësit e tyre të PD-së, deri më tani zyrtarët e PS-së janë treguar shumë më besnikë me emrat që kanë zgjedhur por edhe përgjegjës. Dhe, në lëmin tonë, Ministria e Kulturës nuk ka bërë zgjidhje tjetër veç një ministre, që po bën mandatin e dytë, një nga më të gjatët në krye të këtij dikasteri në vitet e demokracisë.

Nëse kujtojmë se premtimet ishin aq shumë të mëdha, realizimet nuk duken aq të mëdha në këtë dikaster dhe pothuaj në të gjithë të tjerët. Përveç disi maturimit të institucionit dhe

E megjithatë, njerëzit votojnë ata që bëjnë më shumë zhurmë dhe realisht ata që dukshëm nuk punojnë për tagrin e tyre, por shesin vlerën e një pune boshe. Shqipëria është në një qerthull, që shumëkush e kupton, por pakush mund ta ndryshojë, sepse sërish vota shkon tek njerëzit e gabuar...

Edhe në kulturë/E megjithatë, njerëzit votojnë ata që i mashtrojnë më shumë



punëve më shumë me karakter populist. Duke u nisur nga ngjarja e fundit me teatrin: Nuk pritej kursesi të ndërtoheshin kullat në zonën historike, për të cilin ky institucion duhet të bënte avokati të fortë. Ashtu si nuk i falet mungesa e transparencës, fakt që gjithsesi bie përveç saj edhe mbi një Ekzekutiv, që pothuaj ka vetëm një emër. Kryeministri i vendit Edi Rama është aq i sigurt në hapat dhe masat që merr sa që ka harruar se transparenca është një nga elementët kryesorë të demokracisë. Në një akt të pashembullt, njerëzit e tij, jo vetëm e nxorën në pozicion të keq ministrin, që u prononca se nuk kishte projekte për teatrin, porse po tregon se

gjithçka nis dhe varet vetëm e vetëm prej tij.

Po janë kaq të paditur artistët? A është kaq i panevojshëm mendimi i qytetarëve të Tiranës dhe i gjithë Republikës për kulturën që duan, p.sh për një godinë teatri? Janë vallë kaq të keqinformuar edhe vetë drejtuesit e kulturës, të cilat kanë ardhur falë mandateve të tyre. Ne, shqiptarët, ja shkaktojmë vetë të keqen vetes sonë. Kjo që nga alternativat që bëjmë, por edhe mungesën e kulturës për ta kërkuar transparençën e duhur.

Për fat të keq, njerëzit duken kaq shumë e thellësisht të polarizuar në mendimet dhe gjykimet, sa që çdo projekt paragjykohe. Dhe, me të drejtë, kur mungon

transparenca edhe anatomohet keqazi. Shqipëria në çdo hap tregon diferencat kulturore, por edhe mënyrën sesi manifestohen këto ndryshime në fasha shoqërore. E nëse votojmë për njerëz që duhet të na përfaqësojnë, pse vallë çdo grup politik na përcjell në qerthull më të treqzëshëm. Për këtë s’ka aq përgjigje.

Në botë gjykohe se një arsim civil dhe më cilësor mund të ndihmonte që të prisheshin këto barriera, që krijoheshin ndryshimet kulturore, porse realiteti shqiptar po na përshfaq sesi shkolla po e ndih këtë kaos. Dhe, sa më të mëdha që po bëhen diferencat kulturore, aq më keq po shkojnë të gjitha senset e dhura të zhvillimit përfshirë edhe kulturën.

Ndaj u prish pa asnjë llogari pjesa e qytetit antik zejtar në Durrës, ndër gjetjet më të jashtëzakonshme arkeologjike të 50-viteve të fundit, u mbulua kështjella mesjetare në Elbasan dhe kështu me radhë dhe kërcënohen lloj-lloj objekteve ngado.

E megjithatë njerëzit votojnë ata që bëjnë më shumë zhurmë dhe realisht ata që dukshëm nuk punojnë por shesin vlerën e një pune boshe. Shqipëria është në një qerthull, që shumëkush e kupton, por pakush mund ta ndryshojë, sepse sërish vota shkon dhe do të delegohet tek njerëzit e gabuar.

SH
SHKRIM

“Kalendar Historik” i Astrit Lulushit, i arratisur politik nga diktatura komuniste në Shqipëri në vitin 1985, pahtëson edhe dashurinë e madhe të tij për atdheun, detyrimin e tij si intelektual publik për t’i shërbyer vendlindjes me përkushtim e devocion. Ky libër, ashtu si edhe të tjerët nga pena e Lulushit, ka parë dritën e shtypit në Shqipëri, vetëm me shpenzimet e tij, pra pa asnjë lloj sponsorizimi nga shteti shqiptar ose ndonjë biznes, siç veprohet rëndom në raste të tilla. Kjo tregon, përpos të tjerash, se largësia e tij gjeografike me Shqipërinë është shumë herë më e madhe se afërsia shpirtërore tij me vendlindjen.

NGA QERIM VRIONI*

P ara pak muajsh u vu në qarkullim në Tiranë nga Shtëpia Botuese “Tirana&Times” libri me titull “Kalendar Historik: Çfarë ka ndodhur më...?” i studiuësit dhe gazetarit të njohur shqiptar me banim dhe punë në Amerikë, Astrit Lulushi. Ky përbën padyshim një botim krejt të veçantë për Botën Shqiptare të letrave, por edhe si një boshësiplotësues për historinë dhe kulturën shqiptare.

Kalendaret janë disa llojesh, shkencor, kulturor, politikë, fetar, ushtarak etj, por të gjithë kanë si bazë renditjen e termave sipas rrjedhës kohore, ditë, muaj, vit. Në historinë dhe kulturën shqiptare, i pari ndoshta është “Kalendar Kombiar (Kombëtar-shën. im)” i botuar në Sofje (Bullgari) nga Shogëria “Dëshira” në vitin 1897. Ky kalendar ishte një botim i përvitshëm me karakter enciklopedik, kulturor, politik e letrar, po brenda tij të gjitha temat trajtoheshin me frymë të theksuar atdhetare. Ai është botuar me disa ndërprerje dhe numri i fundit i tij i takon vitit 1928, kur botues ishte Lumo Skëndo (Mit’hat Frashëri). Sidoqoftë, kalendari duke ngërthyer fusha të ndryshme, u kthye në një ndihmës të vyer për njerëzit e kulturës, politikës, shkencës dhe jetës shoqërore shqiptare në gjysmën e parë të shekullit të kaluar.

Pas “Kalendar Kombiar” në vend ka qarkulluar “Kalendari i Maleve”, kulturor, shkencor etj, i shtypur në Bruksel (Belgjikë) numri i vetëm më 1900. Mandej, “Kalendari Shoknisë “Dija”, 1906-1910, botim i përvitshëm e shtypur në Vjenë. Ndërsa, një tjetër, “Kalendari Enciklopedik”, nisi botimin më 1933 në Tiranë, dhe kish të karakter enciklopedik, kryesisht ekonomi, arsim dhe shëndetësi.

Pas L2B, Kalendari i parë në vend, u botua më 1945 nga Vasil Xhaçka, që e kishte nisur qysh në vitin 1933. Në vitin 1950, në Tiranë botohet nga “Dega e Historisë Ushtrake” e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore përmbledhja kronologjike me titull “Kalendar Ushtrarak”. Drejtimi i këtij libri ishte politik dhe ushtarak, por përherë nën prizmin e ideologjisë së diktaturës së proletariatit. Brenda tij kishte fakte të shtrembëruara, mohime vlerash, teprime mburrjesh e lëndatash për politikanët e kohës, duke i munguar kështu sensit shkencor i domosdoshëm për punime të tilla. “Kalendari i botës shqiptare” me rreth 540 faqe, i autorit Thimi Çollaku u botua më 2010. Në fund ky kishte edhe Treguesi i emrave, që lehtësonte përdorimin.

Kështu, fusha e Kalendareve në Shqipëri nuk ishte fare tokë e djerrë. Vet titulli “Kalendar His-




“Kalendar Historik” i Astrit Lulushit, një libër me shumë vlerë

torik”, si i pari me këtë emërtim, dallohet nga parardhësit, prej vijës së mirëfilltë shkencore, e cila e përshkon atë tej e mbanë. Më ndryshe, “Kalendar Historik”, nëse do të botohej jo me rendin kohor, por me renditjen sipas alfabetit të emrave të vendeve, njerëzve, ngjarjeve etj, jo vetëm se mund të quhej fare mirë e saktë *Enciklopedi Historike*, por do të ishte *fund e krye* një e tillë. Jo se nuk përbën në të vërtetë një Enciklopedi libri 1200 faqesh dhe i shtypur me cilësi të lartë, por siç u cek më sipër, renditja e zerave në të nuk është alfabetike, por kronologjike, sepse brendia e tij, të drejtun natyrishtem te ky emër i madh.

Për cilën kategori njerëzish është më i nevojshëm “Kalendari Historik” i Lulushit? Pa hezitim e vonesë, përgjigja më e saktë do ishte, *për të gjitha nivelet e moshave, arsimin, kulturën, profesionin etj.* Kjo mbështetet edhe një thënie të popullit, se *çdo njeri nuk ngopet me dituri, pasuri dhe lavdi.* Gjithsesi, në rradhë të parë, ky Kalendar është i nevojshëm për studiuesit shqiptarë të fushave të ndryshme të shkencës dhe artit, të cilat për natyrën e veçantë të tyre kanë fije të domosdoshme lidhëse me historinë. Kështu, ata mund ta shfrytëzojnë atë si burim i ri dhe i besueshëm për disa çështje të ndryshme të së kaluarës, të cilat ende kanë diskutime.

I dobishëm ky botim mendoj se është edhe për nxënësit dhe studentët e shkollave dhe universiteteve, por një libër i vlefshëm mbe-



tet edhe për njerëz të tjerë, të cilët, në përgjithësi, kanë pasur dhe kanë edhe sot *marrëdhënie të ngrohta* me magjinë e librit. Sidoqoftë, ky libër, padyshim, zbulon çdo bibliotekë shtëpie, jo vetëm nga paraqitja e jashtëme, por sidomos nga brendia e tij.

Ndër pikat e forta të këtij punimi madhor të Lulushit përbën edhe përditësimi i të dhënave të hershme për ngjarje të ndryshme të historike. Ato, natyrisht, zëjnë hapësirën më të madhe në libër, madje mendojmë edhe më të rëndësishme të tij. Duke njohur skrupulozitetin e autorit edhe nga botimet e tij të mëprshme, lexuesit ndjejnë siguri kur hasin në faqet e këtij “Kalendar Historik”, të dhëna të kundërta me njohuritë e tyre më të hershme.

Një meritë tjetër e autorit të

librit përbëjnë edhe *fjalët e urta* ose *thëniet e njerëzve të ditur* nga e gjithë bota, të cilat shërbejnë edhe si një kod mirësjelleje dhe edukate e, që ndodhen në fund të shumë faqeve të botimit. Autorët e tyre janë emra shumë të njohur qysh prej lashtësisë e deri në ditët tona, edhe për çështje të kohëve të fundit, të lëmit të etikës, arsimit, shkencës, politikës, kulturës, moralit, jetës së përditëshme, shëndetit, sportit, ekonomisë etj. Këto *fjalë të urta* (pjesë e mençurisë dhe urtësisë botërore) janë shumë të vlefshme e të zgjedhuara me shumë kujdes nga autori, sidomos sot, kur mirësjellja midis njerëzve nuk ka nivele shumë të larta (pavarësisht, nga arsimit, detyra, kultura) dhe *forcë lëvizëse* kryesore mbetet interesi material. Për librin, ngërthen e shpalos mirë edhe vektorin edukativ.

Vlerë e shtuar tjetër e librit qëndron edhe tek gjuha e përdorur nga autori, shumë rrallë në faqet e tij mund të gjendet ndonjë fjalë e huaj e cila nuk është zëvendësuar me atë përkatëse të gjuhës shqipe. Të mos harrohet se bëhet fjalë për një botim vëllimmadh me rreth 1200 faqe të cilat *mbulojnë* shumë ngjarje e figura të rëndësishme të historisë së njerëzimit, natyrisht jo veças nga Shqipëria, por prej të gjithë botës. Libri përmban edhe disa poezi të zgjedhura nga poetë anglezifolës, të përkthyer me sqmë nga autori, i cili e lëvron me ëndje edhe këtë gjini letrare me krijime origjinale.

Për të arritur në faqen e fundit të “Kalendar Historik”, Astrit

Lulushit, me siguri i është dashur të kalojë nëpër duar shumë libra e mjaft revista e gazeta, kryesisht në shqip dhe anglisht, i ka *shtrydhur* ato mirë e mirë, e më pas e ka kondensuar *lëngun*. Nuk kemi të bëjmë vetëm me gjetjen e të dhënave të reja por edhe me përzgjedhjen dhe trajtimin e tyre nën lupën e shkencëtarit dhe artistit. Thënë më ndryshe, për të arritur në faqen e 1200 të librit, me shumë gjasë, nga autori janë lexuar (shpesh edhe rilexuar) disa shumëfisha të këtij numuri katërshifror me faqe të shtypura, janë mbajtur shënime e janë skeduar zera, e sigurisht, nuk duket se ka qënë punë aqë e lehtë. Nuk duhet lënë pa përmendur fakti se për botime të tilla në vende të tjera, normalisht punojnë redaksi të tëra me disa antarë, specialistë të fushave të ndryshme të shkencës, kulturës, ekonomisë, jetës shoqërore etj.

Mendojmë gjithashtu, se faqosja e këtij botimi është mjaft e goditur e me fantazi, madje siç thuhet rëndom, ai përbën një *botim lluksi*. Brenda tij, shumë shpejgime mbi njerëz apo ngjarje shoqërore edhe me fotografim përkatëse, çka e bënë tekstin edhe më të prekshëm për lexuesin.

Kuptohet lehtë se e gjithë kjo punë me atë përkushtim, kanë dashur muaj e vite që të materializoheshin në një libër të madh nga sasia e faqeve dhe nga vlera jo e zakonit e përmbajtjes. Ja vlen të shënohet gjithashtu, se këtu, ashtu si edhe në botimet dhe shkrimet e mëparshme të Lulushit (gjashtë libra origjinale dhe një vëllim me përkthime, përveç dhjetra artikujve), karakteristike është thjeshtësia dhe lakonizmi, ai e shpërfaq mendimin e tij qartë e mënyrë të thukët.

“Kalendar Historik” i Astrit Lulushit, i arratisur politik nga diktatura komuniste në Shqipëri në vitin 1985, pahtëson edhe dashurinë e madhe të tij për atdheun, detyrimin e tij si intelektual publik për t’i shërbyer vendlindjes me përkushtim e devocion. Ky libër, ashtu si edhe të tjerët nga pena e Lulushit, ka parë dritën e shtypit në Shqipëri, vetëm me shpenzimet e tij, pra pa asnjë lloj sponsorizimi nga shteti shqiptar ose ndonjë biznes, siç veprohet rëndom në raste të tilla. Kjo tregon, përpos të tjerash, se largësia e tij gjeografike me Shqipërinë është shumë herë më e madhe se afërsia shpirtërore tij me vendlindjen.

Siç u theksua më sipër, prej më se një shekulli, në gjuhën shqipe janë botuar disa lloje kalendaresh, periodikë apo unikë, por vlerën shkencore dhe praktike të “Kalendari Historik” të Astrit Lulushit, vështrja ta ketë arritur ndonjë paraardhës.

*Studjues i fotografisë

Opinioni *i* Ditës


Një reflektim për katastrofën demografike të vendit

Nga Dritan Hila

(vijon nga faja 1)

... varionin nga 5-12.000 USD, askush nuk e mori si një fakt përtej kronikës së zezë. Dhe këtu nuk bëhet fjalë që shtetas shqiptarë kanë paguar diku tek 10 milionë dollarë për t'u arratisur, por për faktin se nuk ndalon hemorragjia dhe psikoza e ikjes dhe mungesa e shpresës aq e madhe, sa që ikanakët paguajnë një pasuri të tërë vetëm që të ikin. Le të flasim me shifra. Në vitin 1990 Shqipëria kishte 3.3 milionë banorë. Në vitin 2017 mendohet të ketë 2.7 milionë. Ndërkohë 1.4 milionë janë jashtë. Sllobodan Milosheviçi u dënua për gjenocid për dëbimin e një shifre më të vogël shqiptarësh, diku tek 1 milionëshi. Këtu askush nuk mban përgjegjësi nga kjo klasë politike, e cila ka 28 vjet në fuqi. Në çdo vend tjetër ikja në të tilla përmasa e shtetasve të një kombi, në mungesë të luftës, epidemisë apo zisë së bukës, do të ishin dënuar për gjenocid.

Sipas censusit të fundit cituam që jemi diku tek 2.7 milionë, por këta janë ose të mitur, ose të moshuar. Sot krahu i punës ka emigruar dhe mendjet më të mira ikin jashtë. Pallate të tëra në Tiranë tashmë ose janë bosh, ose banohen vetëm nga pleq. Ndërkohë, kryeministri në një nga shpjegimet e veta arrogante për fenomenin, ka deklaruar që të iki kush të dojë, sepse ne do ta bëjmë Shqipërinë me këta që do të rrinë. Mirëpo këta që i kanë mbetur janë fasha joproductive e shoqërisë. Me siguri ka parasysh skemën që të marrë borxhe dhe mbas tij, le të bëhet gameti. Mirëpo puna është se gameti nuk është me dekada larg, por në prag të derës. Kur doja të bëja emisionin e ditës së mërkurë me temë për emigracionin, kërkova në listën e komisioneve parlamentare të partive dhe ajo që më shokoi ishte se grupi i socialistëve emrin më të dëgjuar ka Elisa Spiropalin. Edhe kjo jo për ndonjë studim shkencor, por për punë të tjera. Kusuri ishin tërësisht anonimë. Një nga të paktët deputetë të vjetër, më tha me humor se edhe



vetë anëtarët e komisioneve u natërrrojnë emrat. Kjo tregon se kryeministrin nuk ka kush t'i flasë dhe japë mend, lere pastaj të ketë guximin ta ndalojë. Në krahuin tjetër është opozita më trularaskë në historinë e pluralizmit. Imagjinioni që lajmi më i përfolur ishte 'romanca' e Fevziut me Berishën. Ndërsa kanë një javë që merren me mbrojtjen e kryetarit të bashkisë së një province, i cili ka bërë kërdinë në prona. Mendjet më të mira profesionale të këtij kombi, të majtë dhe të djathtë, ndajnë mendimin që vendi është në rënie të lirë. Ndërkohë, klasa politike ndodhet në delirin e nar-

czimit të vet dhe fundi duket i pamshangshëm. Të dhënat e akademikut Kosta Barjaba, sociologu më i mirë i vendit, tregojnë se deri më sot nga Shqipëria çdo vit largohen dyfishi i shtimit natyror të popullsisë. Tani jemi në fazën kur nuk ka më njerëz që largohen, thonë shifrat e tij. Kushdo burrë shteti serioz do të kishte shpallur emergjencë kombëtare, pasi vendi po kthehet në azil pleqsh, por askush nuk e ka mendjen. Ata që njohin gjeopolitikën dhe mënyrën si funksionon ajo, e dinë se konfirmimi i faktorit shqiptar në fundshekullin e shkuar nuk ka lidhje me legjendat nacionaliste,

por me faktin e thjeshtë të demografisë. Katërfishimi i popullsisë nën sundimi e Hoxhës dhe asaj kosovare matanë kufijve, sollën ridefinimin e kufijve të Ballkanit. Fuqitë e mëdha janë të zhveshura nga mitologjia ballkanase dhe e ndajnë tokën në bazë të frymëve të popullsisë. Sot në të dyja anët e kufirit po përjetojmë zbrazjen e vendit. Nëse nuk merren masa emergjente, nuk do të jetë e largët dita që të bëhemi rishitas shprehje gjeografike. Dhe ashtu si dikur, fajti nuk ka për të qenë i Bismarkut të ri, por yni, i atyre që nuk folën dhe atyre që nuk dëgjuan./dritare.net

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDGJARJA. ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KËRKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

HOROSKOPI

DASHI

Jeni të pavendosur. Nuk dini nëse t'i besoni një detyrë të rëndësishme një personi të ri për ta vënë në provë, ose të veproni si gjithmonë dhe të mos rrezikoni. Gjithçka varet nga rëndësia e çështjes në fjalë dhe vetëm nga ju për ta vlerësuar e për të marrë vendim.

DEMI

Të rebeloheni ndaj një eprori për të kërkuar që të traqeheni ndryshe nuk do të sillte asgjë të mirë. Është më mirë t'i kuptoni këndvështrimin, por pa ngritur zërin. Përmabajni rregullave të vendosura, pasi nuk mund të bëni gjithmonë sipas kokës suaj!

BINJAKET

Për të mos lënduar familjarët apo miqtë, jeni duke humbur veçoritë e karakterit tuaj. Ka ardhur koha të gjeni një ekuilibër midis vetes dhe të tjerëve. Çojini përpara me vendosmëri idetë tuaja, nëse jeni të bindur për qenësinë e asaj që thoni.

GAFORJA

Nëse në të kaluarën jeni tërhequr për të qenë vetëm, tashmë keni dëshirë të zbativni në grup, duke pranuar çfarëdolloj ndryshimi. Ndryshojini pikëpamjet e juaja për t'ju përshatuar partnerit, nëse nuk janë të njëjta.

LUANI

Mund të synoni një objektiv të rëndësishëm, nën bashkëveprimin e Plutonit dhe Uranit dhe një optimizmi të fuqishëm. Por t'i kesh shpatullat e ngrohta nga fati nuk është e gjitha. Mos u mburrni, por vazhdoni të qëndroni i përqendruar në veprimtarinë tuaj.

VIRGJERESHA

Nuk nevojiten shfaqje të jashtëzakonshme dashurie, por të paktën bëjani të ditur partnerit që e doni me të vërtetë. Mjafton pak për t'ia shfaqur! Mos gjeni justifikime banale për t'u tërhequr pikërisht në çastin e fundit. Nuk ju shkon!

PESHORJA

Pavarësisht se dikush është përpjekur t'ju vërë shkopin në rrota, arrini që ta falni e të ecni përpara sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Mund t'i kishit bërë të kuptonte personit përgjegjës se nuk duhet luajtur me zjarrin. Por është e kotë të shohësh mbropa.

AKREPI

Shmangni thashethemet duke mbajtur një qëndrim miqësor. Falë buzëqeshjes suaj të shndritshme, do t'ia dilni të mposhtni çdo kundërshtar. Sepse të tjerët e vlerësojnë punën tuaj, kështu që jepini: nëse e do, gjithçka është e mundur.

SHIGJETARI

Përpikni të jetoni më shëndetshëm dhe të keni një stil jete të qetë, për të shmangur stresin dhe trysinë që po ndikojnë në mirëqenitë tuaj. Nuk është e vështirë të bësh aktivitet fizik, por nevojitet të sforcoheni për të qëndruar në formë.

BRICJAPI

Disa dëshime rrezikojnë që të mos ju lënë të flini i qetë. Por herët a vonë e vërteta del në shesh dhe më në fund do të qetësoheni. Nëse doni t'i jepni fund një lidhjeje që nuk ju përmush më, mendojeni mirë, por më pas veproni.

UJORI

Planetët këshillojnë shumë vetëpërmbytjeje, në mënyrë që të mbani për vete disa sekrete. T'u hapeni të tjerëve gjithnjëherë nuk do të ishte gjë e zgjuar. Mund të konstatoni se besimi që keni tek disa persona të njohur së fundmi nuk ka qenë i arsyeshëm.

PESHQIT

Edhe pse i dini të gjitha përgjigjet, nuk do të thotë se keni arritur përsosmërinë. Bëni kujdes, përpikni të mos jeni të sigurt në vetvetë deri në tej. Është më mirë të mos e merrni çdo gjë gjithmonë seriozisht. Jini më të qetë.

Opinion i Ditës

John Bolton dhe shqetësimi i shqiptarëve

Nga Ruben Avxhiu

(vijon nga faqja 1)

... të Sigurisë Kombëtare. Arsyeja kryesore është se Bolton është një nga diplomatët e rrallë amerikanë, që është shprehur kundër pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

Argumentet e Boltonit ndryshuan disa herë, por për ta përmbledhur, ai paraqiste pavarësinë e Kosovës si diçka që ishte në kundërshtim me interesat amerikanë, si shkelje e ligjit ndërkombëtar, provokim i panevojshëm i Rusisë dhe një pikënisje për shpërthim të radikalizmit islamik në Europë.

Shqiptarët nuk janë të vetmit që e shohin me dyshim emërimin e tij. Shumë nga kritikët e tij e akuzojnë si luftënxitës, si dikë që preferon përdorimin e forcës aty ku diplomacia mund të kishte mjaftuar. Në veçanti, disa janë të shqetësuar se Bolton është sjellë në kabinet nga Presidenti Trump për të grisur Marrëveshjen gjashtë-palëshe me Iranin. Në bazë të saj, Irani ka ndaluar prodhimin e armës bërthamore në shkëmbim të heqjes së bllokadës tregtare. Trump, Bolton dhe një numër i madh politikanesh amerikanë janë të mendimit se Irani është duke e ndërtuar armën bërthamore gjithësesi. Sipas kritikëve të tyre, ata në fakt, thjesht duan luftën e radhës në Lindjen e Mesme. Ironia është se Trump u bë president pas një fushate ku u tall dhe kritikoi ashpërsisht angazhimet ushtarake amerikane në Irak dhe Afganistan. Po ai ka ndryshuar tashmë shumë nga qëndrimet e fushatës.

Për Korenë e Veriut, ai ka këshilluar një goditje paraprake, që sipas tij do ta shpartallonte regjimin dhe do t'ia sabotonte aftësinë për të luftuar seriozisht. Deklarata si këto vetëm sa ia kanë rritur imazhin e dikujt që mund të veprojë në mënyrë të përpërgjegjshme në krye të sigurisë kombëtare amerikane. Koreja e Veriut është peshë e lehtë për t'u ndeshur me Amerikën, mirëpo pesimizistët imagjinojnë skenarin ku një predhë e vetme me përmbajtje bërthamore arrin t'u shpëtojë raketa amerikane, duke vrarë nga dhjetëra mijëra deri në një milion vetë në Korenë e Jugut, Japoni apo edhe në bregu perëndimor amerikan. Fitorja amerikane mund të humbasë shkëlqimin nëse vjen me një çmim të tillë.

Punët e botës po ua lëmë për momentin të tjerëve. Po sa duhet të shqetësohen shqiptarët në Ballkan për këtë emërim të John Boltonit?

Paniku do të ishte pa vend. Madje edhe shqetësimi disi arkaik. Të mos harrojmë se kur John Bolton u deklarua me forcë kundër pavarësisë së Kosovës, ai nuk ishte të më një diplomat në detyrë, por një komentues në media, e një studiues në institucionet e mendimit politik amerikan. Zyrtarët kur



nuk janë më në detyrë shprehin mendime që shkaktojnë debate, por në detyrë ripërqafojnë vendimet dhe synimet e përcaktuara të shtetit amerikan.

E dyta, të mos harrojmë se ambasadori Bolton ishte në atë kohë i inatosur me Presidentin George W Bush dhe sidomos sekretaren e Shtetit, Condoleezza Rice. Ai ishte emëruar fillimisht ambasador në detyrë i SHBA-ve në OKB. Përballë pakënaqësisë në Senatën Amerikanë dhe mes aleatëve të Amerikës për pikëpamjet e tij, administrata vendosi që ta zëvendësojë. Bolton nuk ua fali asnjëherë këtë ndryshim. Nuk është çudi pra, që nëse Bush dhe Rice do të dilnin kundër pavarësisë së Kosovës, Bolton të deklarohet si flamurtar i saj.

E treta, Bolton ashtu siç është normale në SHBA, ishte kundër njohjes së pavarësisë sa kohë që nuk ishte bërë akoma fakt i kryer. Ai vijoi të shprehej kundër saj edhe në javët e para, po qysh atëherë i është shmangur me kujdes temës. Mund të provokohet nga serbët dhe rusët që ta përsërisë dhe mbrojë qëndrimin e tij, po kurrsesi të diskutojë atë që është tashmë një e vërtetë e pakthyeshme. Pavarësia e Kosovës nuk e destabilizoi Ballkanin, përkundrazi rajoni ka mbetur në paqe e bashkëpunimi mes vendeve

finqje, madje edhe mes Prishtinës dhe Beogradit, ka ardhur duke u përmirësuar e forcuar.

E katërta, edhe sikur Bolton të kishte mbetur armik i pavarësisë së Kosovës (e pamundur duke pasur parasysh heshtjen e tij 10-vjeçare, po për hir të argumentit), ai nuk do të kishte kohë që të merrej me të. Ai po hyn në kabinetin "Trump" për t'u angazhuar në fazën e dytë të presidencës, ku të gjithë kohën do t'ia hajë përplasja me Kinën pas fillimit të luftës tregtare, takimi i Presidentit Trump me diktatorin koreanoverior, dhe mbi të gjitha hartimi i një politike të re izoluese dhe luftuese ndaj Iranit dhe regjimit të Ajatollahëve.

Kjo e fundit, më shumë se puna e Kosovës do ta vendosë ambasadorin John Bolton, në radarin e shqiptarëve. Për ata që nuk e kanë vënë re, apo e kanë harruar, Bolton vizitoi Shqipërinë plot një vit më parë, me rastin e festës së Nevruzit, për të festuar së bashku me opozitën e regjimit të Ajatollahëve, që është strehuar në Shqipëri. Këto ditë vizitën e radhës e kreu një tjetër personalitet i afërt me Presidentin Trump, Rudy Giuliani. Nëse Bolton do të hartojë një plan që përfshin nxitjen e rrëzimit të regjimit në Iran, muxhaedinët e strehuar në Shqipëri do të jenë pa dyshim pjesë e tij. Cilat

mund të jenë pasojat për Shqipërinë, është vështirë ta imagjinojë. Ndoshta nuk do të ketë asnjë pasojë, po Tirana ka më shumë arsye se Prishtina që të ndjekë pasojat e emërimit të tij.

E pesta, Bolton është shquar si një nga zërat më anti-Kremlin në SHBA. Edhe me një president që është simpatizues i Putinit, antipatia mbetet. Ajo madje mund të marrë përmasa të tjera, sepse Rusia ka investuar shumë në Iran dhe nuk dëshiron një prishje të marrëveshjes, aq më pak një eliminim të kundërpeshës së Iranit ndaj Arabisë Saudite dhe influencave të tjera në rajon. Moska madje është përfshirë në farkëtimin e një trekëndëshi të paimagjinueshëm pak vite më parë: Rusi-Turqi-Iran. Të tria vendet mund të kishin hyrë në luftë me njëra-tjetrën për shkak të përplasjes së interesave në Siri, mirëpo drujatjia nga kostoja e atij skenari dhe kundërshtimi i përbashkët ndaj një shteti të mundshëm kurd, i ka kthyer në aleatë. Jo pak kanë ndikuar grushti i dështuar i sajuar i shtetit në Turqi, prishja e marrëdhënieve me sauditë dhe turqve dhe sigurisht mosaprovimi mbarëperëndimor për çimentimin e Erdoganit si President i plotfuqishëm në vend, në kurriz të lirisë së medias, funksionimit të opozitës, gjyqeve të pa-

politizuara dhe të paqes me pakicën kurde.


Që të rikthehemi te çështja jonë, vështirë se Bolton do të pranojë diktatin rus në Ballkan, aq më tepër kur marrëdhëniet Moskë-Uashington do të vijnë duke u keqësuar në mënyrë të pashmangshme, pavarësisht nga ndjenjat dhe preferencat e Presidentit Trump.

E gjashta, Bolton nuk do të jetë Sekretar Shteti, postin që ka ëndërruar, por Këshilltar për Sigurinë Kombëtare. Një arsye e thjeshtë është se ky post është i vetmi në kabinet që nuk kërkon miratimin nga Senati Amerikan. Nuk është sekret, se jo vetëm demokratët, por as republikanët në Senat nuk do të votojnë për Boltonin. Nuk e dëshën për ambasador në 2005, nuk e duan në kabinetin presidencial as sot. Ngjytja e tij në kabinet do ndodhte herët a vonë. Shumë shqiptarë dhe jo vetëm ata kanë mbajtur frymë nga perspektiva e Boltonit në kabinet. Në vitin 2008, në 2012 dhe në 2016. Të gjithë kandidatët kryesorë republikanë për presidentë e kanë pasur në krye të listës për Sekretar Shteti. Madje, edhe John McCain e Mitt Romney. Shumë shqiptarë në SHBA kanë pasur një arsye më shumë për të votuar për një president demokrat nga dyshimi që kanë pasur për ambasadorin Bolton. Tani ky "ankth" me apo pa bazë do të shuhet njëherë e përgjithmonë. Ndoshta është më mirë që ai vjen në pushtet tani, kur Kosova është punë e kryer, kur vëmendja ka shkuar tjetërkund dhe kur ai nuk është më aq influencës sa në vitet e mëparshme. E fundit, do të shohim se sa gjatë do të qëndrojë Bolton në administratën "Trump", ku zyrtarët më të lartë po qarkullojnë e zëvendësohen me një shpejtësi relativisht të madhe. Trump nuk është një president i zakonshëm dhe koha ka treguar shumë shpejt se është vështirë për figura me personalitet që të qëndrojnë nën hijen e tij. Përplasjet e mbrapaskenës duken të pashmangshme. Bolton është gjithashtu një personalitet i vështirë. Jo më kot, në vite, ka krijuar kundërshtarë e pakënaqësi të shumta. Ai mund të lulëzojë nën drejtimin e Presidentit Trump, por është më shumë e mundshme që një konflikt të shpërthojë mes të dyve. Trump vjen nga një botë, ku është mësuar t'i qëndrojnë në këmbë, Bolton për një dekadë e gjysmë ka shijuar lirinë e të mos qenit në detyrë, ku ka thënë e ka bërë çfarë ka dashur. Mund të krijojë një duet shumë të mirë, po edhe mund të përplasen në mënyrë të tmerrshme. Koha do ta tregojë.

Deri atëherë, shqiptarët mund ta ndjekin se çfarë do të bëjë njeriu, të cilit i janë druar aq shumë. Është e natyrshme që do të kishim dashur dikë tjetër të emëruar për atë post. Po, sipas gjasave, vështirë se do të ndryshojë ndonjë gjë themelore, për ne e për Kosovën.

"Express"

Fjalëkryqi (1)



37. Fillojnë detyrën.
38. Bektashi këngëtare.
39. Andrea aktore.
41. Sampras i tenisit.
43. Shkroi Korbi (indic).
44. Triolet e Trëndafilit me kredi.
46. Kilmer aktor.
47. Në krye të robotëve.
49. Unë dhe ti.
50. Një mund të jetë fetar.
51. Stephane poet francez

VERTIKAL

1. Fillojnë praktikën.
2. Britna e Arkimedit.
3. Ekstre me trap.
4. Në fund të fundit.
5. Janë fjetoret e ushtarëve
6. Parker regjisor.
7. Vivaldi kompozitor.
8. Një shkop për karambol.
9. Janë firmat rentiere.

HORIZONTAL

1. Riza aktor.
7. Një fjalë si hijë.
11. Një mund të jetë diplomatik.
12. Prenton të bëhet as.
14. Janë felinë... të zinj.
16. Ami i Maupassant.
18. Heroi i Emilio Salgarit.
19. Qe anarkist i famshëm rus
21. Një mungesë gjaku.
22. Susanna shkriktare
23. Të parat në cilësi.
25. Mbyllin një shtëpi.
26. Mbeten në fund.
27. Qendër në kaos.
28. Ka bërë piktoreskë një i tillë
30. Inicialet e Camus.
31. Motra... e Kolë Idromenos
33. Një konfuzion total.
34. Rastet pa set.
36. Rastisin në krye.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

1. Një doktor... i Fritz Lang
6. U paraprinë hoteleve.
11. Kush nuk ka... nuk ha
13. Eshhtë djall
14. Një mund të ketë i rrallë.
15. Ishin perëndi të Samotrakias.
17. Institucione Botuese Autonome.
18. Eshhtë infeksion në bark
20. Fundi i një samurai.
21. Një markë kafeje.
22. Mbyllin një hark.
23. Mund të jetë emërore.
25. Ishite muzikanti që nuk përsiste.
28. Në krye të avokatëve.
29. Qerre pa qe.
30. Një pjesë e adoleshentëve.
32. Një banor imagjinar i planetit të kuq.

VERTIKAL

1. James, armiku i Sherlock Holmes.
2. Eshhtë edhe ajo saudite.
3. Imami aktore
4. I kanë çift turket.
5. Inicialet e Seagal aktor.
6. Eshhtë dëshmore... çudibërëse.
7. Në fund të lutjes.
8. Eshhtë sporti me stil të lirë.
9. Mbeten në fund.
10. Eshhtë rasti i veçantë, karakteristik.
12. Conan ai i Schwarzenegger.
13. Gjysmë ditari.
15. Mario, që qe bomber argjentinas.
16. Mund të prishet nga një... kleçkë.
18. Në hyrje të pistës.
19. Një numër... femrash.
21. Eshhtë qyeti i Besës
24. Qyeti që quhet edhe Sebaste.
26. Njëllot për latinët.
27. Mund të bëjnë stil të lirë.
31. Damon aktor.
33. Eshhtë pije e jona.
34. Në krye të noterëve.
36. Film i Robert Altman.
38. Skuadra merengue.
39. Një pjesë e hasmërisë.
40. Rrallë eshtë përgjysmë.
42. Nisur pa kufij.
45. Fillojnë mobilizimin.



Gjeni ndryshimin

Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra

Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

5	2		9			3	4
6		4				8	1
		9	1		8	3	
8							5
		2	5		9	6	
9		5			4		7
2	1			3		6	9

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	7	2	9	5	6	8	4	3
9	5	4	3	8	7	6	1	2
6	8	3	2	1	4	9	5	7
2	9	1	5	6	3	4	7	8
5	6	7	4	2	8	3	9	1
4	3	8	7	9	1	5	2	6
7	2	5	6	3	9	1	8	4
3	1	9	8	4	2	7	6	5
8	4	6	1	7	5	2	3	9

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	A	R	T	E	K	O	H	A	A	K		
F	I	L	L	I	D	O	M	A	T	E	R	
R	A	F	T	M	I	M	P	A	R	T	S	
A	A	P	E	R	I	P	A	T	I	S	E	
N	H	P	A	K	E	T	I	M	E	T	T	
Z	E	M	E	R	A	K	E	T	S	T	I	
F	I	D	A	N	E	T	V	E	T	E	M	
S	E	N	A	T	I	I	B	E	R	I	K	E
S	E	N	E	K	A	L	L	A	P	A	T	
T	R	E	S	E	L	S	A	T	I	T		
L	T	V	E	T	A	K	A	D				
N	A	A	R	N	J	E	A	P	E	L		

FJALËKRYQI (1)

D	A	L	A	I	V	A	K	A	N	T	E
E	D	E	N	P	N	A	D	I	A	M	
R	R	E	M	I	R	E	T	R	I	O	
T	E	S	T	R	T	A	T	I	O	L	
S	M	N	O	T	A	R	E	T	N	L	
K	A	A	M	E	R	I	K	A	N	E	
E	H	O	F	A	M	A	D	S	H		
K	O	L	O	N	A	G	T	E	C	E	
T	E	N	L	E	T	G	E	R	O	S	
O	R	A	I	T	S	K	E	S	T	I	A
K	A	N	A	K	S	A	R	A	H	E	P
E	T	J	A	C	I	T	A	T	E	T	I

FJALËKRYQI (2)

Argëtim filozofik

-Te jesh gjithmonë i ndershëm me veten, është një ushtrim i këndshëm.
(Sigmund Freud)

-Vlera e një njeriu duhet parë në faktin se çfarë jep, dhe jo në atë se çfarë është në gjendje të marrë.
(Albert Anjstajni)

-Është më mirë t'i meritoni nderet dhe të mos i gëzoni ato, se sa t'i gëzoni dhe të mos i meritoni.
(Mark Tueni)

Thënie të mençura

- Ekziston vetem një sukses - të jesh në gjendje të kalosh jetën ashtu si do vet.
- Christopher Morley (1890 - 1957)**
- Suksesi vjen tek ata që janë shumë të zene duke e kërkuar atë.
- Henry David Thoreau (1817 - 1862)**
- Të gjithë ankohe mi për kujtesë të pamjaftueshme, por asnjë deri më sot nuk është ankuar për mungesë arsyetimit të shëndoshë.
- (Laforushko)**
- Njeriu me të vërtetë i fortë, i pihon dobësitë e veta.
- (Balzak)**

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

6	2	9	13	15	11	7	2		1	11	2	7	
4	9	12	4	11		2		14	13	15	8	2	
	1		12	4	2	12	4	11		6	1	8	
4	11	2		5	10	3	1	15		12	2		
7	4	12		5	10	3	4	6	1	7	2	12	
3			5	10	3	1	14	4	6	1			
4	12	2		5	1	7	2	12		11	4	3	
7	10	6	10	14	4	8		12	10	7	4		
12	11	1		9	4		12	6		8	15	8	
1	12		12	15	12	15		1	12	1		14	
7	2	14	4	12			K	O	P	S	H	3	4
4	12	1	7		9	4	7	9	4	11	4	12	

K R I P T O S K E M E

I	R	S	E	R	B	B	I	D	E	T	
B	E	L	A	M	I	S	R	N	I		
I	I	H	I	P	O	T	E	Z	A	T	
Z	P	A	R	A	K	A	L	I	M	E	T
A	N	E	T	A	R	E	T	L	A	A	
	R	I	T	I	U	I	T	A			
A	T	E	E	M	T	A	I	R	O		
K	E	N	E	T	E	I	T	A	K	A	
T	K	D	T	E	T	E	A	N	T	A	
U	N	I	O	N	M	R	T	K			
A	I	M	I	S	I	O	N	A	R	E	T
L	K	S	T	U	R	I	S	T	E	T	

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

